



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 56 regjistër (JR)
Datë 27.12.2024

Nr. 64 i vendimit
Datë 29.07.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|-----------------------|------------------|
| Ina Rama | Kryesuese |
| Sokol Çomo | Relator |
| Natasha Mulaj | Anëtare |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Mimoza Tasi | Anëtare |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 29.07.2025, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 56/2024 (JR), datë 27.12.2024, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 811, datë 08.11.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, të përfaqësuar nga prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, z. Adnan Xholi, i cili përfundimisht, bazuar në nenet 4, pika 2, 61, pika 3 dhe 5 e 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 811, datë 08.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Eranda Laze, e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi për konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

(i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*

(ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*

(iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*

¹Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

²Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 27.01.2017.

³Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 27.01.2017.

⁴Dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme më datë 27.01.2017, referuar datës në formularin e vetëvlerësimit profesional.

(iv) Nuk ka kryer deklarim të rremë.

(v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, znj. Eranda Laze, nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 811, datë 08.11.2024.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 811, datë 08.11.2024, me shumicë votash, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar vetting, ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ajo ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e

kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

8.2 *Në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

8.3 *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, dosjeve penale të administruara në këtë kuadër, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se, në vlerësimin e përgjithshëm, nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të hetimit të gjithanshëm që kreu në lidhje me vlerësimin profesional, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 20.12.2024, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 811, datë 08.11.2024, për subjektin e rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në konsideratë edhe të “Rekomandimit për paraqitje ankimi” të tre vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit me nr. {***} prot., datë 06.12.2024, të cilin ia ka bashkëlidhur ankimit.
10. Komisioneri Publik pretendoi se vendimi i Komisionit objekt ankimi nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

11. Për rrjedhojë, sipas Komisionerit Publik, në zbatim edhe të rekomandimit të ONM-së, vendimi i Komisionit nr. 811, datë 08.11.2024, është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim pranë Kolegjit, nëpërmjet ankimit, bazuar në nenet Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 4, pika 2 dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik kërkoi marrjen në shqyrtim nga Kolegji të shkaqeve të paraqitura në ankim dhe, në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë:

◦ *Ndryshimin e vendimit nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze.*

12. *Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, referuar kërkesave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.*

12.1. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit "apartament banimi" me sipërfaqe 181,2 m²", me vendndodhje në Linzë, Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të pagesave të këstit të parë dhe këstit të fundit të çmimit të blerjes së kësaj pasurie.*

12.2. *Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën objekt kontrolli, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me rishikimin e saj mbi bazën e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, e cila, sipas tij, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, duke rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë e saj dhe të personit të lidhur me të.*

12.3. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit "tokë" me sipërfaqe 500 m², me vendndodhje në Tragjas, Vlorë, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri të deklaruar si të dhuruar dhe pretendoi se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është rezultat i një analize të plotë, në përputhje me provat e administruara dhe vlerën e tyre provuese.*

12.4. *Lidhur me një ndërtim informal në proces legalizimi, të deklaruar nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri si të paplotë, duke pretenduar se rrethanat e rezultuara në përfundim të hetimit administrativ, lidhen më shumë me personin e lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortin), dhe eventualisht duhen mbajtur në konsideratë për vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

13. *Sa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik pretendoi se situatat e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me shtetasin A. M., edhe nëse nuk janë të tilla që ky shtetas të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të procesit të kontrollit të figurës, ashtu sikurse ka vlerësuar*

Komisioni, të analizuara së bashku dhe të para në raport me njëra-tjetrën, në vlerësim tërësor të procedurave, duhet të ishin vlerësuar më së paku në kuadër të etikës së subjektit të rivlerësimit dhe sjelljes që do të duhet të ishte e pranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

14. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe vlerësimit tërësor të procedurave, në zbatim edhe të rekomandimit të ONM-së të datës 06.12.2024, Komisioneri Publik pretendoi se gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ lidhur me disa udhëtime dhe kontakte me persona të përfshirë ose të dyshuar si të përfshirë në aktivitete kriminale, bazuar në treguesit e përcaktuar për vlerësimin e sjelljes së magistratëve, janë të tilla që vijnë në kundërshti me sa parashikohet në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 dhe udhëzimet ndërkombëtare që rregullojnë sjelljen e magistratëve, si brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik pretendoi se, në vlerësim tërësor të procedurave, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe nuk arrin, sipas tij, nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i Komisionerit Publik si ankues

16. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 811, datë 08.11.2024, për rivlerësimin e subjektit, znj. Eranda Laze, i është njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 06.12.2024, me shkresën nr. {***} prot., të së njëjtës datë, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit më datë 20.12.2024, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 20.12.2024, që rezulton të jetë dita e 14 e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

17. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi kundër vendimit të Komisionit i ushtruar nga Komisioneri Publik, shqyrtohet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve në datat 25.06.2025, 09.07.2025 dhe 29.07.2025.
18. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës⁶ dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore të datës 25.06.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili u përfaqësua në këtë gjykim nga z. Adnan Xholi, prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas autorizimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. {***} prot., datë 19.06.2025.
19. Në seancën e datës 02.04.2025, në parashtrimet e tij lidhur me ankimin, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi, deklaroi se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u qëndron të gjitha shkaqeve të ankimit të ushtruar në datën 20.12.2024 nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 811, datë 08.11.2024, të Komisionit.
20. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues gjatë seancës së datës 25.06.2025, për çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë shkresore të akteve të depozituara gjatë parashtrimeve në Kolegji, trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45 e 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, përveç atyre që nuk plotësojnë elementet e formës në kuptim të ligjit procedural.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

21. Lidhur me shkaku të ankimit për mospërmbysjen e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të pagesave të këstit të parë dhe të këstit të fundit të çmimit të blerjes së pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 181,2 m² (dy apartamente banimi të bashkuar në 1) me vendndodhje në Linzë, Tiranë, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.
22. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme dhe mjaftueshmërisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare të paguajnë në datën 22.12.2009, këstin prej 40.000 eurosh, ndërsa lidhur me këstin prej 10 mijë eurosh, subjekti dhe personi i lidhur e kanë kryer këtë pagesë në fund të vitit 2010 [...], duke rezultuar edhe kjo pagesë

⁶ Referuar parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, me mbarimin e mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

me mundësi financiare të ligjshme. Këtë konkluzion, Komisioni, në mënyrë të përmbledhur, e ka mbështetur në arsyetimin se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit gëzon statusin e personit të lidhur nga data 26.9.2008, datë në të cilën ata kanë filluar bashkëjetesën, pas lidhjes së martesës ligjore dhe se njohja midis tyre nuk përbën ndonjë status ligjor, si rrjedhojë nuk krijon asnjë detyrim ligjor për subjektin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara prej bashkëshortit për periudhën para martese, para datës 26.9.2008. Ndërsa lidhur me kohën se kur subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer pagesën e vlerës 10 mijë euro, Komisioni krijoi bindjen se është fundi i vitit 2010 pikërisht data e dorëzimit të apartamentit nga firma e ndërtimit dhe se përpilimi i mandatarëkëtimit në muajin janar të vitit 2014, lidhet me përgatitjet e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e pasurisë.

23. Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, e kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, në lidhje me vlerësimin që ky i fundit i ka bërë statusit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe burimeve të ligjshme të pasurive të deklaruara, duke e mbështetur këtë shkak të ankimit në pretendimet e mëposhtme.

23.1. Vlerësimi i Komisionit se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit gëzon statusin e personit të lidhur nga data e lidhjes së martesës ligjore, nuk mbështetet nga situata faktike dhe rrethanat e çështjes, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka blerë një pasuri të llojit apartament, në Vlorë, në prill të vitit 2008, pasuri kjo e cila, referuar deklaratimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, është përdorur pa kompensim prej saj, përpara martese dhe gjatë ushtrimit të detyrës, për periudhën shtator 2007 deri në korrik 2008, edhe pse formalizimi i blerjes është kryer në prill të vitit 2008. Gjithashtu, kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si pasuri në posedim dhe si adresë banimi në momentin e plotësimit të kësaj deklaratë. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në kushtet kur ka krijuar një lidhje interesi me bashkëshortin e ardhshëm përpara martese⁷, në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe legjislacionit të zbatueshëm për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, ka detyrimin që të provojë ligjshmëritë e burimeve të krijimit të pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*.

23.2. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për pagesën e kështit të parë të apartamentit të banimit në vitin 2009, në shumën e 40.000 eurove, duke qenë se nuk u provuan burimet e ligjshme të bashkëshortit të subjektit, të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, kursimet në llogaritë bankare dhe ato *cash*. Në këto kushte, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare të vitit 2009. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi ekonominë e përbashkët familjare dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit nga familjarët e tij, të paraqitura gjatë hetimit administrativ, sipas Komisionerit Publik, janë të pambështetura nga aktet në dosje, si dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit. Komisioneri Publik kundërshtoi

⁷ Konfirmuar ky fakt edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet ndaj pyetësorit standard të Komisionit, si dhe si pasojë e aksesit në llogarinë bankare të bashkëshortit para martese, në cilësinë e bashkëmbajtjes së llogarisë në NBG Bank, referuar shkresës së ABI Bank me nr. {***} prot., datë 06.09.2024.

gjithashtu arsyetimin e Komisionit mbi të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të subjektit për periudhën 2004-2009, duke pretenduar se si burime të ligjshme duhet të konsiderohen vetëm ato të ardhura të cilat provohen me dokumentacion justifikues dhe plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

23.3. Komisioneri Publik, bazuar në rekomandimin e ONM-së, pretendoi gjithashtu se konkluzioni i Komisionit lidhur me momentin e pagesës së këstit të fundit për shlyerjen e çmimit të apartamentit të banimit në Tiranë, nuk mbështetet në aktet e administruara në dosje. Sipas Komisionerit Publik, konkluzioni i Komisionit mbi shlyerjen e pagesës së këstit të fundit, në një periudhë të ndryshme nga ajo e dokumentuar në aktet e administruara gjatë procedurës së hetimit administrativ, është i pambështetur në prova, vlerësuar kjo në raport me mandatarkëtimin e shumës prej 11.284 eurosh, të datës 10.01.2014, në arkën e shoqërisë, si dhe me deklaratën periodike të vitit 2010, ku subjekti ka deklaruar shlyerje të pagesës së apartamentit gjatë këtij viti, shumën e 70.000 eurove.

24. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuara pretendimet e Komisionerit Publik në mbështetje të shkakut të ankimit lidhur me pasurinë objekt kontrolli. Në kuadër të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit prapësoi si më poshtë vijon.

24.1. Bashkëshorti i saj nuk kualifikohet si *person i lidhur* apo *person tjetër i lidhur*, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, për kohën para lidhjes së martesës së tyre në datën 26.09.2008, dhe se ata nuk janë gjendur as në rrethana bashkëjetese sipas përcaktimeve të nenit 163 të Kodit të Familjes. Subjekti pretendoi se në përgjigjet e pyetësorit standard, ka shpjeguar hollësisht se për periudhën nëntor 2007 deri në korrik 2008, nuk ka bashkëjetuar me bashkëshortin, shtetasin E. L., në shtëpinë e këtij të fundit, por me shtetasen M. N. (O.) që ka qenë dhe ajo subjekt rivlerësimi. Subjekti pretendoi se ndonëse ka qëndruar gjatë kohës së ushtrimit të profesionit në Vlorë, në apartamentin objekt kontrolli, kjo pasuri e paluajtshme është blerë prej bashkëshortit të saj përpara se ata të njiheshin, edhe pse blerja është formalizuar prej këtij të fundit në muajin prill të vitit 2008. Ky fakt, sipas subjektit, është vërtetuar me fotot e celebrimit të fejesës në nëntor të vitit 2007.

24.2. Lidhur me aksesin në llogarinë bankare të bashkëshortit E. L., subjekti prapësoi se e drejta për të aksesuar llogarinë e tij i është dhënë në muajin gusht 2008, pas kurorëzimit të martesës në datën 27.07.2008, e cila është celebruar ligjërisht në datën 26.09.2008. Pavarësisht këtij fakti, subjekti pretendoi se nuk ka kryer asnjë veprim në këtë llogari, si para dhe pas martesë. Sipas subjektit, në periudhën para martesës ajo dhe bashkëshorti i saj kanë vepruar financiarisht të pavarur nga njëri-tjetri dhe se ajo ka qenë pjesë e familjes biologjike deri në ditën e celebrimit të martesës.

24.3. Pasuritë e paluajtshme “apartament me sipërfaqe 80 m² në lagjen “{***}”, Vlorë, “shtëpi private e përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë, me sipërfaqe trualli 200 m²”, e ndodhur në Durrës, si dhe shuma monetare prej 40.000 eurosh kanë qenë në pronësi të plotë të bashkëshortit dhe se subjekti nuk ka disponuar asnjë të drejtë reale lidhur me to dhe, si të tilla, sipas Kodit të Familjes, konsiderohen pasuri vetjake të tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, të ardhurat e

saj në asnjë rast nuk kanë shërbyer për krijimin e pasurive të sipërcituara dhe kjo provohet edhe nga deklarimi fillestar i bashkëshortit të saj në deklaratën për vitin 2008, në përshkrimin e burimeve të pasurive, sikundër ajo në asnjë rast nuk ka kryer veprime apo transaksione bankare apo jobankare që të kenë lidhje me pagesat e kryera për këto pasuri.

24.4. Referuar akteve të dorëzuara në Komision, provohet fakti mbi jetesën e përbashkët të bashkëshortit të subjektit me familjarët e tij në Itali, nga viti 1996 e në vijim. Subjekti pretendoi se, sipas analizës financiare të kryer mbi bazën e të ardhurave të realizuara nga të gjithë anëtarët e familjes Laze përgjatë periudhës 1998-2008, mundësia e kursimit për këtë familje, deri në fund të vitit 2008, ka qenë në shumën 166.368,03 euro. Më konkretisht, subjekti pretendoi se deri në fund të vitit 2004, mundësia për kursim e familjes së bashkëshortit ka qenë në shumën 74.632 euro, ndërsa deri në fund të vitit 2008, është në shumën 91.736 euro. Bazuar në sa më sipër, sipas subjektit, të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit të saj, të vërtetuara me dokumentacion, në shumën prej 80.308 eurosh, janë kursyer të gjitha, pasi të ardhurat e prindërve kanë përballuar shpenzimet e jetesës për të gjithë familjen.

24.5. Konstatimet e Komisionerit Publik lidhur me burimet e ligjshme të bashkëshortit të subjektit për të krijuar pasuritë e deklaruara, vijnë ndesh me provat shkresore që janë administruar në Komision. Sipas subjektit, vërtetohet qartësisht se shuma prej 40.000 eurosh (kursim i bashkëshortit), paguar si këst i parë në blerjen e apartamentit të banimit në Tiranë, është e ardhur e ligjshme me burim emigracionin.

25. Në lidhje me konstatimin e Komisionerit Publik për pamundësinë e pagimit të këstit të fundit për blerjen e të njëjtit apartament, subjekti i rivlerësimit parashtroi se në praktikën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në Tiranë, gjenden dy mandatarëtime, përkatësisht të datave 22.12.2009 dhe 10.01.2014. Sipas saj, mandati i dytë, i datës 10.01.2014, për pagesën e shumës prej 11.284 eurosh, është nënshkruar mes palëve pasi mungonte dokumenti justifikues për pagesën e kësaj shume dhe kjo pagesë ishte e nevojshme për dokumentimin e pagesave dhe nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitblerjes. Duke qenë se, sipas subjektit, mungonte dokumentimi me mandat i pagesës 10.000 euro në fund të vitit 2010, si dhe pagesës 1.284 euro në fund të vitit 2013, për këtë arsye, para nënshkrimit të kontratës, u nënshkrua mandati i datës 10.01.2014. *Mandati i datës 10.01.2014 lidhet vetëm me dokumentimin e pagesës së mbetur, por jo me faktin se shuma prej 11.284 eurosh është likuiduar nga ana jonë në vitin 2014.*

26. Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, me fokus kontrollin e vendimit të Komisionit në vlerësimin mbi statusin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. E. L., si person i lidhur me të dhe, për pasojë, vlerësimin mbi shtrirjen apo jo të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të pasurive të krijuara nga bashkëshorti i saj para datës së lidhjes së martesës ligjore, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e palëve, si dhe verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

26.1. Referuar të dhënave të certifikatës së martesës të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Vlorë, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze (Felaj), ka lidhur martesë me z. E. L. më datë 26.09.2008, sipas aktit nr. {***} të po së njëjtës datë.

26.2. Nga të dhënat e hetimit administrativ të kryer në Komision⁸, ka rezultuar se për subjektin e rivlerësimit, znj. Eranda Laze, janë referuar, ndër të tjera, edhe këto ndryshime në përbërësit e gjendjes civile: (i) znj. Eranda Laze së bashku me familjen e origjinës janë larguar me ndryshim vendbanimi më datë 04.03.2004, nga Poliçani për në Tiranë, ku rezulton të kenë regjistruar vendbanimin e ri, që më datë 26.02.2004, pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë nr. 7, Tiranë, në regjistrin që i përket rrugës “{***}”. Ky vendbanim përputhet edhe me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi vendbanimin sipas gjendjes civile në DIPPV-të e viteve 2004-2007, ndërkohë që subjekti ka deklaruar edhe adresë tjetër banimi në Vlorë për vitet 2005-2007; (ii) në datën 13.10.2007, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar ndryshimin e vendbanimit në Zyrën e Gjendjes Civile nr. 5, Vlorë, sipas regjistrit “{***}” me zhvendosje nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia nr. 7, Tiranë. Po sipas këtij regjistri, është larguar me martesë në datën 26.09.2008, duke u transkriptuar në po të njëjtin regjistër të Gjendjes Civile “{***}”, me të dhëna të ndryshme të numrit dhe fletës së regjistrit. Nga ky moment deri në datën e raportuar, 23.04.2024, sipas datës së shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur ndryshime të vendbanimit të saj.

26.3. E pyetur nga Komisioni në pyetësorin standard lidhur me adresat e banimit që nga momenti i marrjes së detyrës, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *Njohja me bashkëshortin tim E. L. më krijoi mundësinë e qëndrimit në banesën ku dhe aktualisht banojmë, duke filluar që nga muaji nëntor i vitit 2007. Deri në muajin korrik të vitit 2008 (koha e kurorëzimit të martesës sime), unë kam vijuar bashkëjetesën me shoqen time M.N. Apartamenti 1+1 që ndodhet në rrugën “{***}” [...] ku kam jetuar dhe jetoj aktualisht, është pasuri e krijuar përpara martesë nga bashkëshorti im dhe është deklaruar rregullisht prej tij si në deklaratimin fillestar të pasurisë në emër të bashkëshortit tim, ashtu edhe në deklaratën vetting⁹. Ndërsa në përgjigje të pyetjes nr. 8 të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti, e pyetur se kur ka nisur bashkëjetesën me bashkëshortin e saj, është shprehur: *Fundi i muajit korrik të vitit 2008 që është koha e kurorëzimit të lidhjes sime me bashkëshortin në martesë (në kuptimin tradicional, që nënkupton zhvillimin e ceremonisë martesore) ka qenë pikërisht koha e fillimit të bashkëjetesës ligjore me bashkëshortin tim. Martesa ligjore është lidhur më datë 26.09.2008 [...] në muajin prill të vitit 2008 është formalizuar blerja e apartamentit nga bashkëshorti im (në atë kohë i fejuari im). Fakti që apartamenti i banimit ku kam jetuar bashkë me shoqen time, është blerë nga bashkëshorti përpara kohës së lidhjes së kontratës me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.04.2008, vërtetohet dhe me faktin se në muajin nëntor të vitit 2007 (në datën 03.11.2007), ne kemi zhvilluar ceremoninë e fejesës, pikërisht në këtë banesë.**

⁸ Shih shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nr. {***} prot., datë 23.04.2024.

⁹ Shih përgjigjen e pyetjes nr. 1.

26.4. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si pjesëtar të familjes me detyrim për deklarim edhe bashkëshortin e saj, z. E. L.. Ky i fundit, në rubrikën e pasurive, rezulton të ketë deklaruar: 1. *Një apartament me sipërfaqe 80 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë (kontratë premtim për shitje, datë 09.04.2008, me nr. rep. {***}, me nr. kol., {***}, noter K. P. Vlorë).* (Në rubrikën e vlerës, ka deklaruar shumën 52.000 euro.) 2. *Një shtëpi private, e përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë dhe sipërfaqe trualli 200 m², e ndodhur në Durrës.* (S’ka deklarim të vlerës së pasurisë.) 3. *Depozitë bankare pranë Bankës NBG Vlorë – 10.000 euro; Kursime 30.000 euro. Burimi i krijimit të të ardhurave: Të ardhurat nga emigracioni 1996-2004; Të ardhurat nga aktiviteti privat 2004-2006; Të ardhurat nga aktiviteti publik 2006-2008.*

26.5. Referuar kontratës premtim për shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.04.2008, të lidhur para noterit publik K. P., pala shitëse e ardhshme, z. S. B., dhe pala blerëse e ardhshme, z. E. L., kanë rënë dakord për shitjen në të ardhmen të një apartamenti me një sipërfaqe prej 80 m² në lagjen “{***}”, rruga nr. 5, Vlorë, përkundrejt çmimit prej 52.000 eurosh, i cili referohet shprehimisht në kontratë: *Pala blerëse pranon ta blejë këtë apartament me vlerën e sipërpërmendur, të cilat janë shlyer ndërmjet tyre jashtë zyrës noteriale.* Trupi gjykues konstaton se në këtë kontratë nuk ka asnjë parashikim tjetër përveç objektit të shitjes, çmimit të apartamentit dhe likuidimit të tij. Trupi gjykues vëren gjithashtu se në preambulën e kësaj kontrate, shkruhet: *z. S. B., në bazë të kontratës paraprake të blerjes me nr. rep. {***} dhe nr. kol. {***}, e bërë më datë 19.03.2007 te notere L. C., deklaroi se ka blerë një apartament me sipërfaqe 80 m² të ndodhur në lagjen “{***}”, rruga nr. 5, Vlorë, i cili është në fazën e regjistrimit në ZRPP nga ana e firmës ndërtuese “{***}” ShPK, e cila do të jetë edhe firma që do të bëjë kalimin e pasurisë së apartamentit në emrin e blerësit të fundit, z. E. L..*

26.6. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, rezulton se titulli i pronësisë së kësaj pasurie ka kaluar nga shoqëria ndërtuese në emër të z. S. B., sipas një kontrate shitjeje e cila rezulton të jetë regjistruar në ZVRPP Vlorë më datë 05.04.2012. Ndërsa titulli i pronësisë mbi këtë pasuri të paluajtshme ka kaluar nga z. B. në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në datën 10.10.2023, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.10.2023, të lidhur para noteres publike V. M., vetëm 3 ditë përpara se kjo pasuri të shitej në vijim nga bashkëshorti i subjektit, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.10.2023¹⁰, edhe pse në përgjigje të pyetjes nr. 14 në pyetësonin standard, subjekti i rivlerësimit ka përmendur si kontratë të shitblerjes së këtij apartamenti, kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2012, të lidhur para noteres Xh. L. (motra e bashkëshortit të subjektit) me palë shitëse z. S. B.¹¹, ndërkohë që në deklaratën e pasurisë *vetting*, këtë pasuri e ka deklaruar në posedim dhe jo në pronësi.

¹⁰ Akte këto të depozituara në Komision nga vetë subjekti i rivlerësimit.

¹¹ Shih përgjigjen e subjektit të rivlerësimit në fund të faqes 10 të përgjigjeve të pyetësorit standard, si dhe kontratën e shitblerjes së dorëzuar bashkë me përgjigjet e pyetësorit.

27. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se pretendimet e ankuesit për ekzistencën e një interesi pasuror të krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, para datës së martesës ligjore më 26.09.2008, provohen si të bazuara në fakte dhe pohime të vetë subjektit gjatë procedurës së hetimit administrativ në Komision.
28. Pasuria e krijuar nga bashkëshorti i subjektit para datës së martesës së tyre, e poseduar ligjërisht prej tij sipas veprimit juridik (kontratë për premtim shitje, datë 09.04.2008), është përdorur nga vetë subjekti i rivlerësimit, më së paku që në nëntor të vitit 2007, si rezultat i marrëdhënies së krijuar me z. E. L., me të cilin në muajt në vijim janë lidhur në martesë dhe kanë krijuar familje. Përdorimi prej subjektit të rivlerësimit i pasurisë objekt verifikimi që para formalizimit të marrëdhënies së premtim shitjes nga i fejuari i saj në atë kohë me shitësin e ardhshëm ka ndodhur gjatë kohës që ajo ushtronte detyrën e saj si prokurore në Rrethin Gjyqësor Vlorë, para martesës ligjore, dhe ka vijuar pa ndërprerje deri në momentin e deklarimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, si pasuri në posedim, duke rezultuar që kjo të ketë qenë edhe banesa familjare për periudhën objekt kontrolli. Kontrata premtim shitjeje e kësaj pasurie është lidhur mes bashkëshortit të subjektit dhe shitësit të ardhshëm në prill të vitit 2008, ku çmimi deklarohet të jetë shlyer jashtë zyrës noteriale, pa përcaktim konkret të datës apo mënyrës së shlyerjes së tij, elemente këto të cilat nuk u provuan as gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj.
29. Trupi gjykues vlerësoi me domethënie në analizën e kryer lidhur me pretendimet e ankuesit mbi ekzistencën e interesave pasurorë mes subjektit të rivlerësimit dhe z. E. L. para lidhjes së tyre në martesë edhe faktin e regjistrimit të ndryshimit të vendbanimit nga subjekti i rivlerësimit në tetor të vitit 2007, duke e transferuar atë në qytetin e Vlorës. Ndonëse u konstatua gjatë hetimit administrativ se subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën në qytetin e Vlorës që nga tetori i vitit 2004 dhe ka jetuar në këtë qytet, referuar edhe deklarimeve në ILDKPKI lidhur me adresat e tjera ku ka banuar, pikërisht në tetor të vitit 2007, para formalizimit të fejesës së saj me bashkëshortin e ardhshëm, sipas thënieve të subjektit, kjo e fundit zhvendos vendbanimin e saj nga Tirana në Vlorë, duke e regjistruar atë në Zyrën e Gjendjes Civile nr. 5, Vlorë, sipas regjistrimit “{***}” që përkon me kohën kur fillon të banojë në shtëpinë e bashkëshortit të saj të ardhshëm që e ka vendndodhjen në të njëjtën adresë. Vullneti i subjektit të rivlerësimit për të ndryshuar vendbanimin e saj nga Tirana në Vlorë para ndryshimit të statusit të saj civil, referuar konceptit të dhënë nga Kodi Civil si *vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës*, u vlerësua nga trupi gjykues si tregues, në atë moment kohor, i ekzistencës së një lidhjeje të qëndrueshme me premisë vijimësie të subjektit të rivlerësimit me këtë vendndodhje, e cila përkon me vendndodhjen e pasurisë së z. E. L. dhe konsolidimit të marrëdhënies së saj me këtë të fundit, duke ndërmarrë me vullnet të lirë iniciativën për të vendosur një marrëdhënie juridike të posaçme dhe të vetme me këtë vendndodhje nëpërmjet ndryshimit të vendbanimit¹².

¹² Në nenin 12 të Kodit Civil përcaktohet:

30. Në vijim të sa më sipër, referuar edhe periudhës në të cilën është krijuar pasuria e paluajtshme me vendndodhje në Vlorë, si dhe të faktit që, nga shqyrtimi i akteve në fashikull, bashkëjetesa e pretenduar përgjatë periudhës nëntor 2007- korrik 2008 me një tjetër subjekt rivlerësimi M.N., u paraqit në nivel deklarativ, trupi gjykues krijoi bindjen se marrëdhënia e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj të ardhshëm përfshihet në konceptin e bashkëjetesës, e cila, referuar parashikimit të nenit 163 të Kodit të Familjes, *është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie*. Bashkëjetesë kjo e cila rezultoi të jetë zyrtarizuar në martesë në datën 26.09.2008.
31. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i ankuesit se subjekti i rivlerësimit ndodhet para detyrimit kushtetues dhe ligjor për të justifikuar sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2008 dhe, njëkohësisht, edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, një pjesë e të cilave, likuiditetet në shumën e 40.000 eurove, janë deklaruar edhe si burim për kryerjen e pagesës në të njëjtën shumë, të kështit të parë për blerjen e apartamentit të banimit në Linzë, Tiranë, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte e në ligj.
32. Në kuadër të analizës së mësipërme, lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për pagesën në datën 22.12.2009, të kështit të parë të apartamentit objekt kontrolli, në shumën e 40.000 eurove, për të cilin kishin shërbyer likuiditetet e deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2008, konkretisht depozita bankare në NBG Vlorë, në shumën e 10.000 eurove dhe kursimet në gjendje *cash* në shumën e 30.000 eurove, trupi gjykues vëren si më poshtë.
33. Në deklaratën periodike të vitit 2008, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se për krijimin e apartamentit me sip. 80 m² në lagjen “{***}” në Vlorë, për një shtëpi private 1+1 dhe trull 200 m² në Durrës, të cilën e ka në bashkëpronësi, për krijimin e një depozite bankare në NBG Vlorë në shumën e 10.000 eurove dhe kursime gjendje *cash* në shumën e 30.000 eurove, kanë shërbyer si burim krijimi: *të ardhurat nga emigracioni 1996 – 2004; të ardhurat nga aktiviteti privat 2004 – 2006; të ardhurat nga aktiviteti publik 2006 -2008*.
- 33.1. Pasi qartësoi në seancë publike, nëpërmjet pyetjeve të relatorit të çështjes drejtuar ankuesit, pretendimet e këtij të fundit lidhur me mospërfshirjen si të ardhura të ligjshme nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2004 - 2009, të ardhurat e këtij të fundit të deklaruara si të krijuara pranë shoqërisë “{***}” ShPK gjatë periudhës gusht 2004 - gusht 2006,

“Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij.

Personi nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një vendbanim.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për vendbanimin e veprimtarisë së tregtarit”.

me pretendimin se mbeti e paprovuar dhe e padokumentuar marrëdhënia e punësimit, masa e shpërblimit të përfituar dhe pagimi i detyrimeve tatimore për to, si dhe të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga ushtrimi i veprimtarisë si avokat për vitin 2009, në kushtet e mungesës së konfirmimit të pagesës së detyrimeve tatimore lidhur me qarkullimin e deklaruar sipas fashës takuese 2-8 milionë lekë, trupi gjykues vlerësoi se:

(i) Lidhur me të ardhurat e deklaruara si të krijuara pranë shoqërisë “{***}” ShPK gjatë periudhës gusht 2004 - gusht 2006, Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim për mospërfshirjen e tyre si të ardhura të ligjshme, duke rezultuar ky pretendim i ankuesit pa efekt.

(ii) Lidhur me të ardhurat me burim ushtrimin e veprimtarisë si avokat për vitin 2009, pasi u verifikuan aktet e fashikullit të çështjes, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar në fakte e në ligj pretendimin e ankuesit se, për këto të ardhura, nuk u arrit të provohej kriteri i ligjshmërisë mbi shlyerjen e detyrimeve përkatëse tatimore, duke mos u vlerësuar këto të ardhura si të krijuara në përputhje me standardin e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Kushtetutës, as gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj. Në kushtet që të ardhurat me burim nga avokatia për vitin 2009, nuk janë deklaruar si burim për pagesën e këstit të parë të pasurisë objekt kontrolli, efekti i tyre u vlerësua vetëm në analizën financiare të këtij viti, duke rezultuar me rezultat negativ në shumën e (-) 890.271 lekëve.

34. Ndërkohë, sa u takon të ardhurave me burim emigracionin, ato, edhe pas kontrollit të kryer në Kolegj, paraqiten në shumën e 80.308 eurove, sa konstatuar edhe nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konfirmuar edhe nga ankuesi gjatë shqyrtimit të ankimit në Kolegj. Trupi gjykues vëren se, për të ardhurat e krijuara nga aktiviteti publik i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2006 -2008, nuk ngrihen pretendime, duke mbetur e pacenuar shuma e përlllogaritur nga Komisioni prej 384.209 lekësh për periudhën kohore 22.08.2006 – 30.08.2007, si dhe prej 309.057 lekësh për periudhën 04.02.2008 – 31.12.2008.

35. Në këto kushte, nga analiza e kryer në Kolegj, mbi bazën e: (i) burimeve të mësipërme të të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, konkretisht në shumën e 80.308 eurove me burim emigracionin në Itali për periudhën 1998 - qershor 2004; në shumën totale prej 693.266 lekësh, me burim punësimit në sektorin publik në Shqipëri për periudhën 2006 – 2008; (ii) përlllogaritjeve për shpenzimet e jetesës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit E. L., në shumën 33.117 euro, për periudhën 1998 - qershor 2004, sipas pragut të varfërisë për shpenzimet jetike në Itali¹³; si dhe në shumën 638.634 lekë të përlllogaritur për shpenzimet e jetesës në Shqipëri për periudhën qershor 2004 - dhjetor 2008, sipas INSTAT (të cilat kompensohen nga të ardhurat e përfituara gjatë kësaj periudhe në Shqipëri), duke përfshirë në këtë analizë edhe (iii) investimin e kryer nga personi i lidhur për blerjen e apartamentit në Vlorë në shumën e 52.000 eurove dhe shpenzimin në shumën 875.000 lekë¹⁴ për pjesën takuese të shtëpisë së banimit dhe truallit përkatës

¹³ Referoju faqes në internet: [Soglia di povertà relativa](#).

¹⁴ E konvertuar në shumën 6.900 euro, sipas kursit mesatar zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004, 1 euro = 126,8 lekë.

në Durrës, si dhe likuiditetet në shumën 40.000 euro (depozitë bankare në shumën 10.000 euro dhe kursime gjendje *cash* në shumën 30.000 euro) – trupi gjykues konstatoi se personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në shumën e 51.710 eurove, për të justifikuar pasuritë e deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2008. Në këto kushte, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar në shumën totale të deklaruar si gjendje më 31.12.2008, likuiditetin prej 40.000 eurosh të deklaruar dhe të përdorur si burim për pagesën e kështit të parë të apartamentit objekt kontrolli sipas këtij shkakui ankimi.

36. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti i saj ka jetuar në ekonomi të përbashkët me familjarët e tij në Itali që nga viti 1998 e në vijim, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet zyrtare të lëshuara nga autoritetet e shtetit italian, si dhe konstatoi se, ndonëse referuar certifikatës familjare të lëshuar më datë 23.10.2024, rezultonte se personi i lidhur E. L., me vendbanim në Feltre, në adresën: {***}, ka pasur gjendje familjare së bashku me babain, nënën dhe vëllain (që figuron i martuar me E. L.), vendbanimi i tij, referuar akteve të lëshuara nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore në Itali (INPS), rezultoi i ndryshëm nga vendbanimi i prindërve të tij dhe vëllait të tij nga po të njëjtat akte¹⁵. Në këto kushte, trupi gjykues i gjeti jobindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ekonomi të përbashkët familjare, në kushtet kur, ndonëse në një përbërje familjare, rezidencat e këtyre shtetasve ishin në adresa të ndryshme. Trupi gjykues konstatoi se edhe sipas një analize të ardhurash dhe shpenzimesh në variantin garantist, sipas të cilit kursimet e pretenduara nga emigracioni në periudhën e viteve 1996 - 2004, do të vlerësoheshin si të krijuara në kuadër të një ekonomie të përbashkët të bashkëshortit të subjektit me familjen e tij të origjinës, ky i fundit sërish do të rezultonte me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën prej 28.487 eurosh, për të mbuluar investimet e kryera në disa pasuri të paluajtshme¹⁶ dhe për krijimin e likuiditetit prej 40.000 eurosh, të deklaruar gjendje më 31.12.2008, në formën e depozitës bankare në shumën e 10.000 eurove dhe kursimit gjendje *cash* në shumën e 30.000 eurove.
37. Sa i takon pretendimit të ankuesit lidhur me momentin e pagesës së kështit të fundit të apartamentit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

¹⁵ Referuar aktit të Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore në Itali (INPS), të lëshuar për z. P. L., për periudhën 1999-2010 dhe për znj. H. L., për periudhën 2002-2010, adresa e rezidencës së tyre në: {***} Feltre (BL), ndonëse në të njëjtin qytet, rezultoi e ndryshme nga ajo e djalit të tyre, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Rezidenca e z. E. L., referuar aktit të lëshuar nga INPS për periudhën 01.12.1998 – 30.06.2004, rezultoi të jetë në adresën: {***} Feltre (BL), si dhe në adresën: {***} Feltre (BL), sipas shkresës së Institutit Kombëtar të Sigurimeve ndaj Aksidenteve në Punë (INAIL) të datës 31.10.2002, adresa këto që përputhen me rezidencat sipas Certifikatës Historike të Rezidencës për z. E. L., e lëshuar më datë 22.10.2024, por asnjëra prej tyre nuk përkoi me rezidencën e prindërve në: {***} Feltre (BL), apo me adresën e të vëllait në: {***} Feltre (BL).

¹⁶ Shtëpi private e blerë në bashkëpronësi me të vëllanë T. L. në vitin 2004, në Durrës, si dhe apartament me sip. 80 m² në Vlorë, sipas kontratës “Premtim shitje” të lidhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2008, pasuri e deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, në posedim nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

38. Me anë të kontratës prenotim shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2009, të lidhur para noteres Xh. L. (motra e bashkëshortit të subjektit), bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë rënë dakord për të prenotuar dy apartamente në pallatin që po ndërtonte kjo e fundit në {***}, komuna Dajt, Tiranë, kundrejt çmimit prej 81.284 eurosh. Ky çmim, sipas kontratës, do të shlyhej me këste, përkatësisht: kësti i parë prej 40.000 eurosh, për t’u shlyer në datën e lidhjes së kontratës; kësti i dytë prej 30.000 eurosh, për t’u shlyer në datën e lëvrimit të kredisë, si dhe kësti i fundit për shumën e mbetur, për t’u shlyer në momentin e dorëzimit të apartamentit të përfunduar. Sipas kësaj kontrate, prenotuesi do të quhet pronar i këtij apartamenti pasi të ketë shlyer vlerën totale prej 81.284 eurosh.
39. Apartamentet e prenotuara rezultojnë të jenë regjistruar në pronësi të shoqërisë sipërmarrëse më datë 14.08.2013, referuar certifikatave të lëshuara për këtë qëllim nga ZVRPP Tiranë.
40. Në datën 12.12.2014, përpara së njëjtës notere, znj. Xh. L., është lidhur kontrata noteriale e shitjes mes të njëjtave palë, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., sipas së cilës shoqëria “{***}” ShPK i shet bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dy apartamentet objekt vlerësimi, sipas çmimeve përkatëse të përcaktuara në lekë. Në kontratë, citohet se shumatat e sipërpërmendura janë likuiduar nga pala blerëse te pala shitëse jashtë zyrës noteriale përpara hartimit të kësaj kontrate. Aplikimi për regjistrimin e kontratës së shitjes dhe, rrjedhimisht, titullit të pronësisë së fituar sipas kësaj kontrate është kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, më datë 10.02.2015. Referuar praktikës së regjistrimit të përcjellë nga ZVRPP Tiranë¹⁷, në kuadër të verifikimeve të kryera nga ILDKPKI-ja, rezultoi se pjesë e dokumentacionit janë edhe: (i) 2 mandatarkëtime, përkatësisht ai i datës 22.12.2009, sipas të cilit është arkëtuar nga z. E. L., për llogari të “{***}” ShPK, shuma prej 40.000 eurosh, me përshkrim: “Kësti i shtëpisë”, si dhe mandatarkëtimi i datës 10.01.2014, sipas të cilit rezultoi që të jetë arkëtuar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, nga z. E. L., shuma prej 11.284 eurosh, me përshkrim: “Për blerje apartamenti, objekti Tiranë”; si dhe (ii) një vërtetim nga NBG Bank i datës 22.01.2015, me anë të të cilit konfirmohet nga ana e bankës, kalimi i shumës prej 29.100 eurosh në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrim: “Këst apartamenti sipas kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., dhe kontratës së kredisë nr. {***}”.
41. Nga verifikimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se, sikundër pretenduar edhe nga ankuesi, në deklaratën periodike të vitit 2010, në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, teksa ka deklaruar prenotimin e dy apartamenteve sipas kontratës së prenotimit nr. {***}, datë 22.12.2009, ka deklaruar shprehimisht edhe: *Paguar 40.000 + 30.000 euro*. Gjithashtu, në rubrikën e vlerës së pasurisë, ka deklaruar shumën 81.284 euro, ndonëse nuk rezultoi të ketë plotësuar përkatësisht edhe rubrikën e detyrimeve të pashlyera në vlerën prej 11.284 eurosh.
42. Bazuar në sa konstatuar më sipër dhe në konsideratë të parashikimit ligjor të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mbi fuqinë provuese të deklaratave periodike në këtë proces, trupi gjykues e gjeti të bazuar në aktet e fashikullit të çështjes dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi,

¹⁷ Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 28.09.2017.

pretendimin e ankuesit se konkluzioni i Komisionit për pranimin e pagesës për shlyerjen e këstit të fundit të apartamentit në një moment të ndryshëm kohor nga sa provohet nga aktet në dosje, është një konkluzion i papabazuar dhe, rrjedhimisht, i gabuar.

43. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi shlyerjen në mënyrë pjesore të këstit të fundit (10.000 euro në fund të vitit 2010 dhe pjesa e mbetur prej 1.284 eurosh në datën sipas mandatpagesës së dytë) nuk u provuan as pas gjykimit të çështjes në Kolegj. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se mandati i dytë i datës 10.01.2014, për pagesën e shumës prej 11.284 eurosh, është nënshkruar mes palëve pasi mungonte dokumenti justifikues për pagesën e kësaj shume dhe kjo pagesë ishte e nevojshme për dokumentimin e pagesave dhe nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitblerjes, sikundër dhe arsyeja e dhënë nga Komisioni në vendim se përpilimi i mandatarëkëtimit në muajin janar të vitit 2014, lidhet me *përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e pasurisë*, u çmuan jobindëse. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se mandatarëkëtimi objekt shqyrtimi nuk duket të jetë përpiluar në funksion të përgatitjes së praktikës për regjistrimin e kontratës së shitjes, sa kohë rezultoi si më sipër konstatuar, se ishte plotësuar rreth 1 vit më parë nga momenti i aplikimit për regjistrim të kontratës në 10.02.2015, ndryshe nga vërtetimi i NBG Bank, i cili ishte lëshuar nga kjo e fundit disa ditë para aplikimit, sikundër nuk u vlerësua bindës shpjegimi i dhënë për nevojë të dokumentimit të pagesave të kryera për efekt të lidhjes së kontratës së shitblerjes, për sa kohë rezultoi se kontrata e shitblerjes ishte lidhur më datë 12.12.2014, gati 1 vit pas mandatarëkëtimit.
44. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se ky mandatarëkëtim, bashkëlidhur kontratës noteriale të shitjes, të lidhur mes bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, pjesë e praktikës së regjistrimit të pasurisë objekt kontrolli në ASHK, i vlerësuar në harmoni me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në deklaratat periodike vjetore para ILDKPKI-së, nga të cilat nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte deklaruar pagesën e detyrimit të mbetur si pretenduar në vitet 2010 dhe 2013, përbën provë në lidhje me momentin e pagesës së këtij kësti. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se verifikimi i mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për mbulimin e këstit në shumën e 11.284 eurove, do të kryhet mbi bazën e një analize të ardhurash dhe shpenzimesh të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për periudhën nga data 01.01.2014 deri në datën e pagesës së këstit, sipas mandatarëkëtimit të datës 10.01.2014. Nga analiza e kryer si më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodheshin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën e 1.537.654 lekëve për mbulimin e këstit të fundit të blerjes së apartamentit, që përkon përafërsisht me vlerën e plotë të tij¹⁸.
45. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj, pretendimin e ankuesit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për pagesën e këstit të parë në shumën prej 40.000

¹⁸ Kësti në shumën 11.284 euro konvertohet në shumën e 1.587.320 lekëve sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën e pagesës prej 1 euro = 140,67 lekë.

eurosh, si dhe të këstit të fundit në shumën prej 11.284 eurosh, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

46. *Lidhur me analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit për periudhën objekt kontrolli, Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, kundërshtoi si të pabazuar rezultatin e kësaj analize dhe pretendoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në përfundim të hetimit administrativ në Komision, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj dhe të personit të lidhur me të. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këto pasuri, referuar kërkesave të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*
47. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, Komisioneri Publik pretendoi si të pabazuar: (i) rishikimin nga ana e Komisionit të analizës financiare të paraqitur me raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ për vitin 2008, në drejtim të investimeve të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të këtij viti, të të ardhurave të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të zërit të shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë; (ii) përfshirjen nga Komisioni në analizën financiare të vitit 2010, të pagesës së pjesshme prej 10.000 eurosh të këstit të fundit të apartamentit, si dhe mospërfshirjen në zërin e shpenzimeve të kësaj periudhe të shumave që kanë rezultuar të tërhequra nga llogaria bankare, në shumën totale prej 2.948.863 lekësh, si dhe pretendimin se shuma e depozituar në llogarinë bankare në emër të bashkëshortit të subjektit pranë ABI Bank (ish-NBG) në datën 3.3.2010, prej 12.249 eurosh, tejkalon kursimet *cash* të deklaruara të akumuluar deri në fund të vitit 2009, duke afektuar për pasojë burimet e ligjshme të këtyre depozitimeve; si dhe (iii) vlerësimin e burimeve të ligjshme të pagesës së kryer për këstin e fundit të apartamentit në analizën financiare të vitit 2014 dhe jo në atë të kryer për vitin 2010.
48. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në kundërshtimin e këtij shkaku ankimi, në parashtrimet e saj para trupit gjykues në Kolegj, prapësoi se rishikimi nga Komisioni i analizës financiare për vitin 2010, me të drejtë nuk ka përfshirë si shpenzime lëvizjet bankare në shumën 2.948.863 lekë, për shkak se këto transaksione nuk janë kryer as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga bashkëshorti i saj, fakt ky, sipas subjektit, i provuar nëpërmjet kryerjes së ekspertimit grafik të datës 27.10.2024, nga eksperti kriminalist A. R., sipas të cilit ka rezultuar se asnjë transfertë nuk është kryer nga bashkëshorti i subjektit. Subjekti parashtrroi se kronologjia e veprimeve të kryera në këtë llogari, të cilën Komisioneri Publik e ka konsideruar si shpenzim, fillon me transfertën e kryer nga vëllai i bashkëshortit në shumën 7.024 euro, në datën 3 mars 2010, po në të njëjtën ditë është depozituar shuma 5.225 euro. Shumat e transferuara dhe të depozituara janë tërhequr ndërmjet datave 3-4 mars 2010. Në datën 12 mars 2010, është depozituar shuma prej 5.000 eurosh dhe në datën 16 mars 2010, është tërhequr shuma prej 3.500 eurosh (data këto gjatë të cilave subjekti i rivlerësimit pretendoi se, së bashku me bashkëshortin, kanë qenë jashtë Shqipërie). Gjithashtu, në datën 19.03.2010 është depozituar shuma 1.500 euro, e tërhequr në vijim gjatë muajit prill, si dhe në datën 07.06.2010 është kryer një depozitim dhe tërheqje e së njëjtës shumë prej 5.000 eurosh.

49. Sipas subjektit, veprimet e kryera në këtë llogari, të cilat Komisioneri Publik i ka konsideruar si shpenzime, janë shuma të depozituara, të tërhequra dhe të ridepozituara në vijim dhe jo si pretenduar nga Komisioneri Publik, si vlera monetare të palidhura me shumatat e mëparshme. Subjekti parashtrroi se, nëse në një llogari bankare ka transaksione të derdhjeve dhe tërheqjeve, sipas rendit që derdhja pasardhëse është kryer pasi është tërhequr shuma e derdhjes së mëparshme, kjo mënyrë nuk mund të krijojë “multiplikator në përlllogaritje”, pasi është e njëjta shumë monetare që derdhet dhe tërhiqet gjithmonë. Sipas subjektit të rivlerësimit, për sa kohë provohet se depozitimet dhe tërheqjet nuk janë kryer nga bashkëshorti i saj, por janë transaksione të kryera nga persona të tretë, Komisioni me të drejtë nuk i ka përfshirë në analizë financiare.
50. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit mbi burimet e ligjshme të pagesës së kështit të parë të apartamentit të banimit në Linzë, Tiranë, si dhe me momentin kohor të pagesës së kështit të fundit të të njëjtit apartament, gjeti të drejtë dhe të bazuar pretendimet e ankuesit lidhur me: (i) kryerjen e analizës financiare për vitin 2008, nëpërmjet verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të të ardhurave në raport me shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet e kryera për investimin në pasuri të paluajtshme dhe likuiditete, të depozituara në bankë dhe gjendje *cash* në banesë; (ii) përfshirjen e shpenzimit të kryer për pagesën e kështit të fundit të apartamentit të banimit në Linzë, Tiranë, në shumën e 11.284 eurove, në vitin 2014 dhe jo në vitet 2010 dhe 2013 si përlllogaritur nga Komisioni, duke konkluduar për korrigjimin respektivisht të analizave financiare të kryera nga Komisioni për këto vite.
51. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se rishikimi nga ana e Komisionit i analizës së kryer fillimisht me rezultatet e hetimit dhe mospërfshirja në shpenzimet e periudhës së vitit 2010, e shumave të cilat kanë rezultuar të tërhequra nga llogaria bankare, në shumën totale prej 2.948.863 lekësh, është e pabazuar, pasi pretendimet e subjektit të rivlerësimit *mbetën në nivel deklarativ dhe jo në përputhje me legjislacionin e fushës*, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe dëgjoi shpjegimet e palëve në lidhje me këtë shkak të ankimit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
52. Në dokumentin e rezultateve të hetimit, Komisioni, gjatë analizës së kryer mbi vlerësimin e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit të tipit “Mercedes Benz” në vitin 2010, ka pasqyruar si shuma të shpenzuara vlerën e rezultuar nga tërheqjet bankare në shumën e 2.948.863 lekëve dhe, si rrjedhojë, kjo analizë ka rezultuar me një pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën e 2.686.984 lekëve. Në kuadër të sa më sipër dhe për të provuar të kundërtën e këtij rezultati, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës¹⁹. Gjithashtu, në të njëjtin dokument, në pjesën “Çështje të tjera”, Komisioni është shprehur: *7.2 Sipas informacionit të ABI Bank, subjekti është bashkëmbajtëse e llogarisë nr. {***} (ish nr. {***}) të z. E. L., ku për periudhën 3.3.2010 – 7.6.2010, ka rezultuar se llogaria është kredituar në total në shumën 23.749 euro dhe*

¹⁹ Shih faqen 20 të rezultateve të hetimit.

debituar në total në shumën 21.250 euro. Subjekti duhet të provojë burimin e ligjshëm të shumave të kredituara, si dhe të japë shpjegime në lidhje me destinacionin e përdorimit të tyre²⁰.

53. Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në shpjegimet e saj ndaj rezultateve të hetimit, është shprehur: *Në analizën financiare të vitit 2010, janë përfshirë si shpenzime lëvizjet bankare në shumën 2.948.863. Këto lëvizje bankare nuk janë kryer nga bashkëshorti im. Ky fakt provohet me aktekspertimin grafik nënshkrimi, çka provon se të gjitha transfertat nuk janë kryer nga bashkëshorti. [...] Në datën 23.10.2024, më është dërguar nga ABI Bank nëpërmjet e-mail-it, dokumentacioni përkatës dhe kemi konstatuar se nënshkrimi “Emër, mbiemër, Firmë E. L.”, në të gjitha mandatpagesat, për çdo tërheqje shume monetare në këtë llogari bankare, nuk është nënshkrimi i bashkëshortit tim, gjithashtu nuk rezulton që bashkëshorti të ketë kryer depozitim të ndonjë shume monetare në këtë llogari. [...] Përveçse është e dukshme, në funksion të provueshmërisë së këtij fakti, është kryer ekspertim grafik nënshkrimi nr. {***}, datë 27.10.2024 [...]. Nga përmbajtja e mandateve të depozitimit të shumave monetare, rezulton se asnjë depozitim nuk është kryer nga bashkëshorti im, depozitimet e shumave përkatëse janë kryer nga shtetasit T. L. dhe T. N., të cilët kanë qenë punonjës në këtë bankë [...]. Kjo tregon që kjo llogari bankare është përdorur nga të tretë në padijeninë tonë, këtë e vërteton jo vetëm fakti që mandatet e tërheqjes së shumave monetare nuk janë nënshkruar nga bashkëshorti im, por edhe natyra e kryerjes së veprimeve bankare, depozitime dhe tërheqje në cash të shumave monetare respektive, në po të njëjtën ditë, në po të njëjtin hark kohor, tregon se mund të jetë përdorur kjo llogari për efekt të kryerjes së këmbimit valutor.*
54. Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur një aktekspertim grafik nënshkrimi nr. {***}, datë 27.10.2024, të kryer me kërkesë të subjektit të rivlerësimit nga eksperti kriminalist ing. A. R., me nr. {***} në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve, referuar vërtetimit elektronik të datës 14.10.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
55. Referuar këtij aktekspertimi grafik të nënshkrimit, eksperti kriminalist Artan Rexhepi ka arritur në konkluzionet se nënshkrimet në emër të shtetasit E. L. në mandatpagesat e Bankës Kombëtare të Greqisë: nr. {***}, datë 03.03.2010; nr. {***}, datë 03.03.2010; nr. {***}, datë 04.03.2010; nr. {***}, datë 16.03.2010; nr. {***}, datë 01.04.2010; nr. {***}, datë 20.04.2010; nr. {***}, datë 07.06.2010; nr. {***}, datë 09.04.2010 – nuk janë nënshkruar nga shtetasi E. L..
56. Nga verifikimi i kryer nga trupi gjyqësor lëvizjeve të kësaj llogarie në lidhje me transaksionet e kryera në llogarinë bankare në emër të bashkëshortit të subjektit pranë ABI Bank (ish-NBG)²¹, rezultoi se:
- në datën 03.03.2010, është transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, shuma prej 7.024 eurosh, transferuar nga T. L., sipas mandateve në fashikull;

²⁰ Shih faqen 21 të rezultateve të hetimit.

²¹ Subjekti është bashkëmbajtëse e llogarisë nr. {***} (ish nr. {***}) të E. L..

- në të njëjtën datë, 03.03.2010, rezulton e depozituar *cash* nga T. L., shuma prej 5.225 eurosh, në total depozituar *cash* shuma 12.249 euro në këtë datë;
- në datën 03.03.2010, rezultojnë të tërhequra *cash* shumat prej 5.225 eurosh dhe 500 eurosh (nga E. L.);
- në datën 04.03.2010, rezulton e tërhequr *cash* shuma 6.525 euro nga E. L.;
- në datën 12.03.2010, rezulton të jetë depozituar *cash* shuma 5.000 euro nga T. L.;
- në datën 16.03.2010, rezulton të jetë tërhequr *cash* shuma 3.500 euro nga E. L.;
- në datën 19.03.2010, rezulton të jetë depozituar *cash* shuma 1.500 euro nga T. N.;
- në datat 01.04.2010 - 14.05.2010, rezulton të jenë tërhequr *cash* ose transferuar në llogari tjetër, shumat në total prej 2.805 eurosh, nga të cilat shuma 1.000 euro në datën 01.04.2010 dhe shuma 525 euro në datën 20.04.2010, referuar mandateve bankare, rezultojnë të tërhequra nga E. L.;
- në datën 07.06.2010, rezulton të jetë depozituar *cash* shuma 5.000 euro nga T. L. dhe të jetë tërhequr brenda së njëjtës datë nga E. L.;
- në datën 13.07.2010, rezulton të jetë depozituar *cash* shuma 250 euro nga E. L. dhe në datën 14.07.2010, të jetë depozituar *cash* shuma 85 euro nga T. L., në total shuma prej 335 eurosh;
- në datën 14.07.2010, është transferuar/debituar në llogari tjetër shuma 380 euro, nuk kuptohet nga akti se kush është përfituesi i kësaj shume.

57. E pyetur gjatë seancës gjyqësore të datës 25.06.2025 nga relatori i çështjes për të shpjeguar në mënyrë të përmbledhur se çfarë ka ndodhur me llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit, ku kjo e fundit rezulton të jetë bashkëmbajtëse e kësaj llogarie, subjekti ka pohuar: *Atëherë, më lejoni të saktësoj paraprakisht se kjo llogari bankare ka qenë një ndër tri llogaritë bankare të bashkëshortit tim, që janë identifikuar nga ABI Bank. Unë, në pyetësorët që më janë dërguar gjatë hetimit administrativ, jam vënë në dijeni që kam pasur edhe le të themi cilësinë e bashkëmbajtëses së kësaj llogarie. Por që, në fakt, kjo llogari nuk është përdorur nga unë dhe statement e tregojnë qartësisht këtë gjë. Gjithashtu, ky ka qenë edhe momenti ku na kanë vënë në dijeni që në këtë llogari bankare, për një periudhë kohore të shkurtër, duke filluar nga muaji mars i vitit 2010, deri në muajin shtator të vitit 2010, ka pasur lëvizje bankare. Dhe në verifikimet që kam bërë unë të datave, ka rezultuar në datat, në mos gaboj, 16 dhe 19 të këtij muaji që janë kryer depozitime dhe tërheqje të shumave respektive, unë jam ndodhur jashtë shteti së bashku me bashkëshortin, në Amerikë. Dhe në momentin e parë përgjigjja ime drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka qenë që kjo llogari bankare sigurisht që është aksesuar nga të tretë. Ndërkohë, më janë vënë në dispozicion mandatpagesat në të cilat kam konstatuar se nënshkrimi në emër të bashkëshortit sigurisht që nuk përputhej me nënshkrimin e tij. Për këtë arsye, unë i jam drejtuar ekspertit kriminalist, z. D. R., i cili ka përpiluar aktin përkatës grafik të nënshkrimit dhe ka konkluduar se nënshkrimi nuk është i bashkëshortit tim. Çka vërteton në mënyrë të plotë që kjo llogari bankare është aksesuar nga të tretë. Kam dyshuar që kjo llogari mund të jetë përdorur për shkak të një transferte fillestare që është bërë nga vëllai i bashkëshortit, i cili ka qenë punonjës pranë bankës NBG në atë kohë, se më tej ka kaluar në ABI Bank. Por më ka rezultuar që këto veprime bankare, për të cilat unë referova që janë kryer në kohën kur jam ndodhur jashtë shtetit, në këtë udhëtim ka*

qenë dhe vëllai i bashkëshortit, pra ka qenë së bashku me ne. Kam gjykuar nga mënyra se si janë kryer lëvizjet bankare që ka pasur depozitime dhe tërheqje të po kësaj shume brenda një harku të shkurtër kohor, për të mos thënë disa minuta, dhe kam dyshuar që këto mund të jenë bërë edhe për efekt përfitimi të ndonjë punonjësi të bankës duke bërë exchange, le të themi me shumat përkatëse. Këto janë dyshimet e mia. Gjithsesi, fakt është që llogaria bankare në asnjë moment nuk është përdorur as nga unë, as nga bashkëshorti im. Sa i takon pyetjes lidhur me veprimet e ndërmarra për të sqaruar dyshimet mbi këtë situatë dhe përdorimin e llogarisë nga persona të tretë, subjekti ka deklaruar: *sa i përket momentit të denoncimit të këtij fakti të konstatuar, duke pasur parasysh kohën se kur janë kryer këto veprime bankare, sepse i referohemi vitit 2010, dhe unë kam marrë dijëni në vitin 2024, besoj që ky kallëzim i imi për të evidentuar, le të themi, personin përgjegjës që ka kryer këto veprime bankare në mënyrë të paligjshme, sigurisht që nga ana e prokurorisë, në kuptim të ligjit penal, nuk do të fillojë një procedim penal për shkak se ka kaluar afati 14 vite, pra është parashkuar vepra penale që ka ndodhur në vitin 2010. Dhe kjo ka qenë arsyeja që unë nuk e kam vijuar më tej denoncimin e rastit të konstatuar. [...] duke qenë se kjo ka qenë një llogari bankare, pra në NGB Bank, dhe më tej gjithë dokumentacioni bankar ka kaluar në ABI Bank, banka ka qenë le të themi kufizuese për sa i përket vënies në dispozicion. Pra, janë vënë në dispozicion ato dokumente, të cilat kanë qenë objekt ekspertimi. Banka nuk na ka dhënë një informacion të mëtejshëm për mënyrën sesi është operuar nga punonjës brenda bankës, për të vetmen arsye, besoj, që nuk e ka pasur këtë informacion sepse janë dy banka të ndryshme. Domethënë, banka nga ku marrim ne sot informacion me bankën që është operuar në vitin 2010.*

58. Në analizë të sa më sipër konstatuar, për shkak të paqartësisë së situatës faktike dhe rrethanave specifike të rezultuara gjatë hetimit në Komision, si më sipër evidentuar, lidhur me transaksionet e sipërcituara në llogarinë e përbashkët bankare të personit të lidhur E. L. dhe subjektit të rivlerësimit, në ish-NBG (sot ABI Bank), trupi gjykues vlerësoi të mos përllogarisë si shpenzime të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit) shumën prej 2.948.863 lekësh, të rezultuar nga tërheqjet bankare të shumave të depozituara gjatë këtij viti me të njëjtën vlerë. Në këto kushte, pas korrigjimit të analizës financiare të Komisionit për këtë vit lidhur me mospërllogaritjen e pagesës së pjesshme të këstit të apartamentit në shumën e 10.000 eurove të përfshira nga Komisioni si shpenzim i kryer në këtë vit, analiza financiare e këtij viti rezultoi me balancë pozitive.
59. Lidhur me shkakun e ankimit për pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë” me sipërfaqe 500 m², me vendndodhje në Tragjas, Vlorë, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se konkluzioni i Komisionit nuk është rezultat i një analize të plotë, në përputhje me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren si vijon.
60. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie të paluajtshme të ndodhur në Tragjas, Vlorë, ka konkluduar në vendim se: *në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se toka bujqësore objekt analize vjen si pasojë e një akti dhurimi, i përpiluar me vullnetin e lirë të personave, për shkak si të marrëdhënies me personin*

e lidhur, por dhe të ndihmës juridike që ky i fundit i ka dhënë. Nga hetimi u provua se kjo pasuri nuk vjen si pasojë e një kontrate shërbimi për të cilën personi i lidhur do të kishte detyrimin të paguante detyrimet tatimore. Ky qëndrim është koherent si në kontratën e dhurimit, në deklaratën noteriale, gjatë procesit, edhe në deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Ky akt nuk përbën një rast konflikti interesi për subjektin dhe nuk ka asnjë element që mund të jetë një indicie për ndikimin e subjektit në këtë pasuri.

61. Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, kundërshtoi këtë konkluzion të Komisionit dhe pretendoi se përfundimi i arritur prej këtij të fundit mbi këtë pasuri, nuk është rezultat i një analize të plotë, në përputhje me provat e administruara dhe vlerën e tyre provuese. Komisioneri Publik pretendoi se, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit dhe shpjegimeve të subjektit, në gjendjen që janë aktet, mbetet e paqartë dhe joezauruese në drejtim të largimit të çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse marrëdhënia e bashkëshortit të subjektit me dhuruesit ka qenë shpërblim/pagesë/kompensim për shërbimet ligjore të ofruara nga bashkëshorti i subjektit, për të cilën, duke e trajtuar si dhurim, nuk është lëshuar faturë dhe nuk është kryer pagesë e detyrimeve tatimore, apo thjesht në kuadrin e mirënjohjes për dhënien e një asistence teknike, orientuese ligjore. Sipas Komisionerit Publik, nga aktet e administruara gjatë procesit në Komision, nuk rezultoi të jetë provuar nëse ka pasur ndonjë procedurë gjyqësore, në të cilën bashkëshorti i subjektit ka marrë pjesë për të mbrojtur palët e përfshira në dhurim, nëse ai është kujdesur për regjistrimin e këtyre pasurive në ZVRPP-në e Vlorës apo të ketë asistuar me procedurat e kompensimit pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mënyrë që të arrihej një konkluzion përfundimtar mbi ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie²².
62. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në parashtrimet e saj para trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, prapësoi se pretendimet e ankuesit për paqartësi apo edhe hipoteza e ngritur prej tij lidhur me këtë pasuri, janë hamendësime, sepse koha e kryerjes së dhurimit, deklarimi në kohë në deklaratën periodike vjetore të kontratës së dhurimit, vlera e sendit të dhuruar, deklaratata noteriale e një prej dhuruesve, ezaurojnë, sipas saj, në mënyrë të plotë dhe konfirmojnë shpjegimet e dhëna nga bashkëshorti i saj.
63. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe shqyrtoi pretendimet e palëve në lidhje me krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
64. Sipas “Kontratës së dhurimit” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.05.2014, të lidhur para noteres Xh. L., ky i fundit, në cilësinë e pranuesit të dhurimit, ka përfituar nga N. H. dhe V. H., në cilësinë e dhuruesve, të përfaqësuar përkatësisht nga A. H., A. H. dhe V. H., pasurinë e paluajtshme të llojit tokë pyll e kullotë, me sipërfaqe 500 m², të ndodhur në Tragjas, Vlorë. Sipas përcaktimit në këtë kontratë: *Pala dhuruese ka dëshirë t’i dhurojë palës pranuese të dhurimit këtë parcelë. Pas përfitimit nga dhurimi, pala pranuese e dhurimit bëhet pronar i ligjshëm i kësaj parcele.*

²² Referoju poshtëshënimit nr. 22 të ankimit objekt shqyrtimi.

65. Sikundër parashtruar edhe nga ankuesi lidhur me arsyet e dhurimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka deklaruar: [...] *Bashkëshorti im E. L. ka pasur njohje të hershme fillimisht me shtetasin A. N. H., më pas me dy vëllezërit e tij, shtetasit V. H. dhe A. H.. Shtetasi A. H. dhe vëllezërit H. janë në lidhje familjare, kushërinj të parë. Në cilësinë e avokatit, bashkëshorti ka ofruar konsulencë juridike në lidhje me procesin e regjistrimit të pasurive të llojit tokë bujqësore, me vendndodhje fshati Tragjas, të trashëguara nga gjyshi i tyre shtetasi S. H.. Bashkëshorti E. L. ka ndjekur edhe procedurën e regjistrimit të pasurive pranë zyrës së regjistrimit Vlorë.*
66. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.05.2024, të shtetasit A. H., në të cilën deklaroi se: [...] *Me avokatin E. L. kam njohje që në fëmijëri. Arsyetja e dhurimit të sipërfaqes prej 500 m² sipas kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.5.2014, pjesë e pasurisë (tokë me sipërfaqe mijëra ha) që kemi trashëguar nga i ndjeri gjyshi im S. H., ka qenë vlerësim për konsulencën juridike dhe punën që avokati ka kryer në lidhje me regjistrimin e tyre, të ndodhura në Tragjas, Vlorë [...].*
67. Ndërkohë që nga ana e Komisionit i është kërkuar të depozitohet kontratën e shërbimit dhe faturën për shërbimin e bashkëshortit si avokat i familjes H. në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion lidhur me shërbimet profesionale të kryera nga bashkëshorti i saj për familjen H., duke dhënë këtë përgjigje: [...] *Në rastin konkret, qoftë konsulencia juridike që u është ofruar nga bashkëshorti pjesëtarëve të familjes H., qoftë dhe ndjekja e procesit të regjistrimit të pronës, nuk ka pasur për qëllim marrjen e një shpërblimi, sepse në të kundërt do të ishte bashkëshorti që do të përcaktonte vlerën e shpërblimit për punën e kryer. Për shkak të marrëdhënieve të hershme shoqërore të bashkëshortit tim me shtetasin A. H., si dhe të marrëdhënieve shoqërore të familjes së shtetasit A. H. me familjen e bashkëshortit në vijim të njohjes edhe me shtetasit, bashkëshorti i ka orientuar, sugjeruar, këshilluar e ndihmuar dhe fakti që disa vite më vonë nga ofrimi i konsulencës juridike, është bërë ky dhurim, ka qenë në kontekstin e mirënjohjes²³.*
68. Rezultoi gjithashtu se edhe me shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit në Komision, si dhe gjatë gjyqimit të çështjes në Kolegj, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me natyrën e bashkëpunimit të bashkëshortit të saj me familjen H., duke mos dorëzuar ndonjë dokumentacion justifikues lidhur me shërbimet e ofruara.
69. Gjithashtu, e pyetur nga relatori i çështjes lidhur me arsyen e dhurimit të pasurisë objekt kontrolli nga dhuruesit bashkëshortit të subjektit, si dhe me formën e dhënies së konsulencës juridike për dhuruesit, kjo e fundit pohoi se: *Në fakt, dhurimi nuk është se lidhet me mua si subjekt rivlerësimi, lidhet me bashkëshortin tim dhe arsyeja, domethënë nuk mund të gjej një arsye le të themi të një dhurimi, se dhurimi në fund nuk kërkon ndonjë arsye domosdoshmërisht. Dhurimi mund të bëhet*

²³ Për më shumë, shih përgjigjen e subjektit të rivlerësimit lidhur me pyetjen nr. 10 të pyetësorit nr. 3 të Komisionit.

edhe në kontekstin e një mirënjohjeje, sikundër është shpjeguar qoftë nga bashkëshorti im, qoftë edhe nga pala dhuruese, i cili nëpërmjet deklaratës noteriale që ne kemi depozituar në Komision, ka referuar për ndihmë juridike, për konsulencën juridike që është ofruar prej bashkëshortit tim. [...] po konsulenca sigurisht që ka qenë verbale, juridike, i ka orientuar për mënyrën sesi duhet të ndërmerrnin hapat për regjistrimin e pasurisë, madje dhe e ka ndjekur këtë procesin e regjistrimit. [...] duke qenë se ai është avokat i së drejtës civile, pra i ka njohuritë besoj dhe secili prej nesh ka nevojë në një moment të caktuar të këshillohet me dikë të fushës për të pasur një konsulencë të qartë në lidhje me rastin në fjalë, gjë që mendoj është bërë dhe nga dhuruesit në raport me bashkëshortin tim.

70. Subjekti mohoi që bashkëshorti i saj të ketë përfaqësuar në cilësinë e avokatit, në ndonjë çështje gjyqësore që lidhej me interesat pasurorë të dhuruesve në këtë pasuri, apo të ketë kryer ndonjë procedurë pranë Agjencisë së Kompensimit dhe Kthimit të Pronave për kthimin e pronës së dhuruar. Ndërsa, lidhur me pyetjen nëse bashkëshorti i saj kishte kryer veprime konkrete për regjistrimin e pronës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, subjekti u përgjigj se nuk mund ta thotë këtë me siguri: *Bashkëshorti po, mendoj që mund... d.m.th., e ka ndjekur këtë si procedurë regjistrimi, por për shkak të pamundësisë së vënies në dispozicion tashmë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ta verifikuar praktikën konkrete, d.m.th., unë nuk jam në gjendje që, le të themi, të jem e qartë në këtë, nëse ka ndonjë nënshkrim të bashkëshortit tim në praktikën, d.m.th., në aplikimin kur është bërë për regjistrimin e kësaj pasurie. Domethënë këtë gjë nuk mund ta them, nëse konsultohem me dokumentacionin përkatës [...]*²⁴.
71. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i pyetur nga relatori i çështjes mbi nevojën e hetimeve shtesë në kuadër të shkakut të ankimit lidhur me këtë pasuri, si dhe kualifikimin ligjor të situatës faktike të pretenduar, u shpreh se: *Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, konsiderohen të mjaftueshme dhe nuk lind nevoja për kryerjen e hetimeve shtesë [...] lidhur me kualifikimin ligjor të çështjes [...] vlerësohet se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse në raport me aktet në dosje dhe subjekti i rivlerësimit, referuar nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, duket se është përpjekur të paraqesë ndryshe situatën faktike në drejtim të besueshmërisë së deklarimeve të saj.*
72. Në përfundim të sa më sipër, në lidhje me pretendimet e ngritura nga ankuesi për pasurinë e llojit “tokë” me sipërfaqe 500 m², ndodhur në Tragjas, Vlorë, dhuruar bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga shtetasit N. H. dhe V. H.²⁵, trupi gjykues, pasi mori në analizë edhe legjislacionin e zbatueshëm në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit edhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk shpjegoi bindshëm natyrën e marrëdhënies së bashkëshortit të saj me dhuruesit e pasurisë së paluajtshme, në drejtim të shuarjes së çdo dyshimi të arsyeshëm lidhur me ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur. Ndonëse situata faktike e konstatuar gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë pasuri, si më sipër evidentuar, nuk

²⁴ Referoju procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 25.06.2025, ora 1:12:06 pm – 1:16:10 pm.

²⁵ Të përfaqësuar në kontratën e dhurimit përkatësisht nga A. H., A. H. dhe V. H.

mund të kualifikohet në një prej situatave të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ajo u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

73. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik mbi kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit në lidhje me ndërtimin informal në proces legalizimi, të deklaruar nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i cili ka rezultuar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
74. *Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me këtë ndërtim informal, ka arritur në konkluzionin se, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se nuk rezultuan indicie apo prova që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit të subjektit.*
75. *Komisioneri Publik e kundërshtoi si të paplotë këtë konkluzion dhe pretendoi se, lidhur me këtë çështje, referuar akteve të fashikullit, kanë rezultuar disa rrethana të cilat, sipas tij, duket se lidhen më shumë me personin e lidhur të subjektit të rivlerësimit (bashkëshortin E. L.) dhe, për rrjedhojë, Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegji që këto rrethana të mbahen në konsideratë për vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*
76. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në parashtrimet e saj para trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj lidhur me këtë shkak ankimi, prapësoi se deklarata e legalizimit nuk është firmosur nga shtetasi P. L.. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ditët e qëndrimit të vjehrrit të saj në Shqipëri, nuk ndikojnë mundësinë e tij për të investuar në një ndërtim pasi objekti nuk është ndërtuar me punë vullnetare të deklaruesve, por nga punëtorë të fushës së ndërtimit. Subjekti pretendoi që marrëdhënia që kanë pasur prindërit e bashkëshortit të saj me prindërit e së ndjerës T. K. është reflektuar edhe në marrëdhënien e tyre. Lidhur me udhëtimin e kryer në datën 26.11.2012, të evidentuar nga Komisioneri Publik në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendoi se kanë qenë edhe dy prindërit e bashkëshortit të saj, si dhe bashkëshorti i së ndjerës T. K., shtetasi A. H., çka, sipas saj, tregon për njohje të prindërve të bashkëshortit me pjesëtarët e familjes së shtetases R. K.. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka shpjeguar se kjo marrëdhënie nuk ka asnjë lloj lidhje me të dhe bashkëshortin e saj dhe se nuk ka deklaruar asgjë tjetër që do të cilësonte kontradiktor një deklaram të mëparshëm, edhe nëse do të ekzistonte një i tillë. Në mbështetje të sa pretenduar, subjekti dorëzoi në Kolegj edhe akte provuese të cilat u administruan nga trupi gjykues në cilësinë e provës²⁶.*
77. *Gjithashtu, e pyetur nga relatori i çështjes lidhur me arsyen/motivin e babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për të ndërtuar një garazh në Dhërm, kjo e fundit pohoi se: unë mund të sqaroj kuptimin pse nuk ka vijuar ndërtimi [...] një përgjigje të saktë sigurisht që mund ta japin*

²⁶ *Deklaratën noteriale të shtetasit A. H. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2025, si dhe fletë të printuara nga sistemi TIMS të cilat u verifikuan nga trupi gjykues nëpërmjet aksesimit të drejtpërdrejtë të kësaj platforme në Kolegj.*

vetë personat që janë të përfshirë në këtë proces, d.m.th., që kanë ndërmarrë të tillë situatë, pra kanë ndërtuar një objekt të tillë informal dhe kanë deklaruar që ky ndërtim është bërë në vitin 2008. Fakti që nuk ka vijuar më tej, pra ka mbetur vetëm si një garazh objekti, sigurisht që lidhet edhe me qasjen time për sa u përket ndërtimeve të paligjshme. [...] sigurisht kjo i është bërë me dije edhe vjehrrit tim, prandaj dhe ndërtimi nuk ka vijuar, d.m.th., ka ndenjur aty dhe nuk është ndërmarrë asnjë lloj iniciative, le të themi për ta legalizuar këtë si objekt, sepse është një ndërtim i kryer në kundërshtim me ligjin dhe nga aplikuesit nuk është vijuar më tej për legalizimin e këtij objekti.

78. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe shqyrtoi pretendimet e palëve në lidhje me krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
79. Sa u takon fakteve dhe rrethanave të evidentuara nga Komisioneri Publik në ankimin e tij²⁷ lidhur me: (i) mosprezencën e babait të bashkëshortit të subjektit, z. P. Xh. L., në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 03.10.2014²⁸, kur rezulton të jetë nënshkruar prej tij dhe vetëdeklarueses tjetër, shtetasen R. Th. K., “Deklarata për përfshirje në procedurat e legalizimit”; (ii) qëndrimin e tij në Shqipëri vetëm për një periudhë disaditore gjatë vitit 2008, kur rezulton të jetë kryer ndërtimi pa leje²⁹; (iii) sipërfaqen e tokës që rrethon ndërtimin informal të pretenduar nga subjekti me destinacion përdorimi “garazh”; (iv) marrëdhënien avokat-klient të krijuar mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe vajzës së vetëdeklarueses R. Th. K., znj. T. M. K., për mbrojtjen e kësaj të fundit në gjykimin e çështjes penale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë³⁰, ku ajo akuzohej për konsumimin e veprave penale të parashikuara nga nenet 186/3 (Falsifikimi i dokumenteve) dhe 248 (Shpërdorimi i detyrës) të Kodit Penal; si dhe (v) udhëtimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me automjetin me targë {***}, në datën 26.11.2011, të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe disa shtetasve të tjerë, ndër ta dhe znj. T. K.³¹ – trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, vlerësoi se ato janë konstatuar saktë dhe në mënyrë të plotë.
80. Në analizë të sa më sipër, në konsideratë edhe të qëndrimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për moskryerjen e hetimeve shtesë lidhur me këtë çështje, trupi gjykues gjeti të drejtë pretendimin e ankuesit se, nga aktet e administruara në proces lidhur me këtë pasuri, evidentohen rrethana të

²⁷ Referoju paragrafëve 13.6 dhe 13.6.1 të ankimit të Komisionerit Publik, objekt shqyrtimi.

²⁸ Referuar të dhënave të sistemit TIMS, z. P. Xh. L. ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 29.03.2014 dhe ka dalë prej tij në datën 24.08.2014, për t’u rifutur në vitin pasardhës 2015, në datën 23 maj.

²⁹ Referuar të dhënave nga sistemi TIMS, z. P. Xh. L. gjatë vitit 2008 ka qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë nga data 20.07.2008 deri më 08.08.2008.

³⁰ Shih aktet e procedimit penal nr. {***}/2009 të Prokurorisë së Rrethit Vlorë, të dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përcjellë në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. {***} prot., datë 01.10.2024.

³¹ Referuar të dhënave të sistemit TIMS, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. H., F. H., M. H. dhe T. K. kanë udhëtuar më datë 26.11.2011, me automjetin me targë {***}, nga pika kufitare Kakavijë (regjistrimi në dalje nga territori shqiptar rezulton vetëm për shtetasen T. K.).

cilat lidhen më shumë me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë të këtij të fundit me vajzën e vetëdeklarueses R. K., sesa me babain e bashkëshortit, z. P. L., për marrëdhënien e të cilit me znj. R. K. nuk evidentohet asnjë e dhënë, e cila mund të qartësojë natyrën e saj dhe motivin për angazhimin tyre në një investim të përbashkët për kryerjen e këtij ndërtimi informal, referuar edhe “Deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit”, në të cilën rezultojnë të dy si nënshkrues.

81. Trupi gjykues vlerësoi se, edhe në këtë rast, lidhur me ndërtimin informal në proces legalizimi (vetëdeklaruar nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) në Dhërmi, subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse lidhur me arsyet e babait të bashkëshortit të saj, për të investuar së bashku me një shtetase tjetër në një ndërtim pa leje, të pretenduar nga subjekti me destinacion përdorimi si “garazh”, në një fshat turistik, ndonëse jeton që prej vitit 1996 në Itali.
82. Në kushtet kur kjo situatë faktike, e konstatuar si më sipër gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk mund të kualifikohet në një prej situatave të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ajo u mbajti gjithashtu në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

83. *Sa i takon kriterit të kontrollit të figurës, për të cilin Komisioneri Publik pretendoi se situatat e rezultuara nga hetimi administrativ, lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me shtetasin A. M., edhe nëse nuk janë të tilla që ky shtetas të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të procesit të kontrollit të figurës, ashtu sikurse ka vlerësuar Komisioni, të analizuara së bashku dhe të para në raport me njëra-tjetrën në vlerësim tërësor të procedurave, duhet të ishin vlerësuar më së paku në kuadër të etikës së subjektit të rivlerësimit dhe sjelljes që do duhet të ishte e pranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.*
84. Komisioni, lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, Komisioni e ka arritur pasi ka arsyetuar se: subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaratën për kontrollin e figurës, pavarësisht dijenisë ose jo të saj lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2012 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”. Formalisht, emri i shtetasit A. M. nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Nga ana tjetër, udhëtimi i subjektit me persona të cilët mbrohen nga bashkëshorti i saj si avokat, tregon që subjekti i rivlerësimit duhet të tregojë një kujdes të shtuar lidhur me këtë fakt, me qëllim eliminimin e këtyre situatave të cilat, në dukje, mund të sjellin probleme lidhur me etikën e një*

magjistrati, pavarësisht faktit se në asnjë rast nga hetimi, nuk rezultoi që subjekti të ketë vepruar në gjendje konflikti interesi.

85. Komisioneri Publik konstatoi në ankimin e tij se procedimi penal nr. {***} i vitit 2012, është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën për më shumë se 10 vite dhe rezultoi të jetë hetuar për një periudhë trevjeçare, deri kur për këtë procedim, me vendimin e datës 23.7.2015, është disponuar për pushimin e çështjes. Gjithashtu, nga sistemi TIMS, ka rezultuar se në datën 08.11.2015, rreth tre muaj pas vendimit për pushimin e këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me shtetasin A. M. dhe bashkëshorten e tij. Bazuar në këto konstatime, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e mësipërm të Komisionit dhe pretendoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi këtë udhëtim, si një udhëtim pune të bashkëshortit, ku përveç tyre (subjektit, bashkëshortit dhe njërit prej djemve të tyre), kanë qenë dhe shtetasit A. M. dhe V. M. (bashkëshortë) pa pasur njohje të mëparshme, si dhe për mungesë dijenie për zhvillimet e një procedimi penal për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal lidhur me këtë shtetas, janë jobindëse.
86. Komisioneri Publik pretendoi se fakti që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka udhëtuar në vijim me shtetasin A. M., në vitin 2016, dhe ka shërbyer si avokati i tij në procedimin penal nr. {***}, në vitin 2018, të regjistruar në ish-Prokurorinë për Krimet e Rënda, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a (Trafikimi i narkotikëve) i Kodit Penal duhen vlerësuar në kuadër të dijenisë për marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me këtë shtetas, në referim edhe të detyrimit ligjor për deklaram. Sipas Komisionerit Publik në ankim, pa vënë në diskutim vlerën provuese të dokumentit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, shkresës nr. {***}, datë 24.10.2024, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në të cilën thuhet: *[...]në regjistrin e çështjeve penale nuk ka emër të regjistruar si person që i atribuohet kryerja e veprës penale, arrestuar/ndaluar apo si person i pandehur [...]*, Komisioni nuk duket të ketë administruar dosjen penale të çështjes në fjalë, për të konkluduar mbi pozitën procedurale të këtij shtetasi gjatë këtyre viteve.
87. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, prapësoi se çdo konstatim që Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim, që tenton të cenojë integritetin dhe figurën e saj, është tërësisht i pabazuar në ligj dhe në prova. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka pasur asgjë për të fshehur përderisa udhëtimi i referuar nga ankuesi, nuk ka rezultuar nga hetimi administrativ, por është deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit standard. Subjekti pretendoi se nga aktet e fashikullit të këtij procedimi penal, kjo çështje penale nuk është hetuar prej saj dhe ajo nuk ka pasur mundësi të kishte dijeni për ekzistencën e një çështjeje të tillë, për sa kohë në regjistrin e çështjeve penale nuk është shënuar emri i personit në fjalë. Subjekti pretendoi se raporti i rezultateve të hetimit nga Komisioni, është përgatitur në shkelje të procedurës për administrimin e provave të kërkuara prej tij, pasi ka rezultuar se ky raport është përgatitur pa pritur dosjen penale të vitit 2012. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, deklarata për kontrollin e figurës është plotësuar në vitin 2017 dhe ajo nuk kishte si

të parashikonte se çfarë do të ndodhte në vitin 2018. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik nuk është konseguent në vlerësimet e tij, sepse referon se edhe nëse shtetasi A. M. nuk konsiderohet kontakt i papërshtatshëm, duhet të analizohet në kuadër të vlerësimit të etikës së subjektit të rivlerësimit dhe të sjelljes që duhet të ishte e pranueshme për të pasur besimin e publikut te drejtësia.

88. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se dyshimi i Komisionerit Publik nëse shtetasi A. M. është apo jo kontakt i papërshtatshëm me të, si subjekt i procesit të rivlerësimit vetëm për faktin se ekziston procedimi penal i sipërcituar, me të dhënat, përmbajtjen dhe konkluzionet e bëra nga organi procedues, Prokuroria Vlorë, sipas akteve të vetë dosjes, është i pabazuar në ligj dhe në praktikën gjyqësore të zhvilluar nga gjykatat më të larta në vend dhe GjEDNj-ja, lidhur me kuptimin e “kontaktit të papërshtatshëm”. Subjekti rikonfirmoi gjithashtu qëndrimin e mbajtur në Komision se udhëtimi objekt shqyrtimi, i lindur në rrethana krejt rastësore, ishte për shkak të punës së bashkëshortit të saj dhe jo të subjektit.
89. Trupi gjykues – gjatë seancës gjyqësore të datës 25.06.2025, pasi konstatoi se dosja e procedimit penal nr. {***}/2012 është përcjellë në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, së bashku me kopjen e akteve të këtij procedimi³², në vijim të kërkesës së Komisionit³³ dhe është protokolluar në Komision³⁴ një ditë pasi ky i fundit ka marrë vendimin për përfundimin e hetimit administrativ, më datë 14.10.2024, duke mos e marrë në analizë dhe përfshirë në dokumentin e përgatitur në kuadër të rezultateve të hetimit administrativ, në kuadër të sqarimit të pretendimit të ankuesit në ankim dhe në parashtrimet e tij para Kolegjit se: “Nuk duket që Komisioni të ketë administruar dosjen penale të çështjes nr. {***} të vitit 2012, për të konkluduar mbi pozitën procedurale të shtetasit A. M. gjatë këtyre viteve” – kërkoi qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme lidhur me sa më sipër.
90. Në vijim të qartësimit nga ana e përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e tij para Kolegjit se: *Nga aktet nga të cilat ka administruar Komisioneri Publik, rezulton se nuk janë të plota [...] në momentin e trajtimit të ankimit sipas informacionit që kemi marrë dhe lidhur nga situata që janë katër fashikuj do të na duhet që të kemi të plotë që të katër fashikujt për të konkluduar në lidhje me këtë pikë, trupi gjykues vendosi të administrojë në cilësinë e provës së re katër fashikujt e përcjellë në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. {***} prot., datë 10.10.2024, dhe që i përkasin procedimit penal me nr. {***}/2012, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.*
91. Në fazën e bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u shpreh se: *Në referencë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, pas verifikimit të akteve*

³² Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 10.10.2024.

³³ Me shkresën nr. {***} prot, datë 09.10.2024.

³⁴ Me nr. {***} prot., datë 15.10.2024.

*në dosjen përkatëse të procedimit penal nr. {***}/2012, administruar nga Kolegji në seancën e datës 25.06.2025, vlerësohet se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit konsiderohen bindëse në raport me mungesën e dijenisë mbi procedimin penal ndaj shtetasit A. M., në kushtet kur rezultoi e provuar se emri i këtij shtetasi nuk rezultoi të ishte regjistruar në regjistrin e veprave penale të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu, edhe nga verifikimi i fashikullit të administruar në Kolegj, rezultoi se procedimi penal me nr. {***}/2012 ishte trajtuar nga prokurorë të tjerë pranë kësaj prokurorie deri në pushimin e çështjes në vitin 2015.*

92. Ndodhur në këto kushte, pasi konstatoi qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në fazën e bisedimeve përfundimtare, për heqjen dorë nga shkaku i ankimit në lidhje me situatat e rezultuara nga hetimi administrativ në Komision, mbi kontaktet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me shtetasin A. M., trupi gjykues, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoi se konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, mbeten të pacenuara.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

93. *Sa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe vlerësimit tërësor të procedurave – për të cilin Komisioneri Publik, në konsideratë të rekomandimit të ONM-së së datës 06.12.2024, pretendoi se gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, lidhur me disa udhëtime dhe kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë ose të dyshuar si të përfshirë në aktivitete kriminale, si dhe lidhur me faktin e pranimit të mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit nga klientët e bashkëshortit të saj, janë të tilla që vijnë në kundërshti me parashikimet e nenit 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 dhe udhëzimet ndërkombëtare që rregullojnë sjelljen e magistratëve si brenda, ashtu edhe jashtë sistemit gjyqësor – trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.*

➤ *Lidhur me të dhënat e rezultuara gjatë hetimit administrativ në lidhje me shtetasin A. H.:*

94. Trupi gjykues vëren se, referuar pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim, bazuar mbi gjetjet e hetimit të kryer nga Komisioni, verifikuar edhe nga trupi gjykues pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të çështjes, ka rezultuar se:
- (i) referuar të dhënave të sistemit TIMS, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar me një automjet që ka qenë në përdorim të shtetasit A. H., ndërsa bashkëshorti i subjektit ka udhëtuar disa herë me të njëjtin shtetas gjatë periudhës kohore 2017 – 2020;
 - (ii) në kuadër të hetimit të kryer nga Komisioni³⁵, rezultoi se për shtetasin A. H., është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, procedimi penal me nr. {***}/2020, për veprat penale të parashikuara nga nenet 274³⁶ dhe 242³⁷ të Kodit Penal, për të cilin, në përfundim të hetimeve, është konkluduar me vendim pushimi, ndërkohë që nuk ka pasur dhe nuk ka të

³⁵ Referuar shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nr. {***} prot., datë 19.09.2024.

³⁶ Neni 274, “Prishja e qetësisë publike”.

³⁷ Neni 242, “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

regjistruar çështje penale për këtë shtetas pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar³⁸;

(iii) referuar burimeve të hapura, në media, Komisioni ka konstatuar se shtetasi A. H. akuzohet për vepra penale të lidhura me trafikimin ndërkombëtar të narkotikëve³⁹.

95. Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, teksa është pyetur lidhur me konstatimin e mësipërm mbi të dhënat nga sistemi TIMS, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Unë, e shoqëruar nga tre fëmijët e mi dhe shtetasit [...] jemi nisur nga USA për në Shqipëri, fillimisht nëpërmjet linjës ajrore New York – Milano dhe, në funksion të kthimit tonë nëpërmjet rrugës tokësore dhe detare Milano – Brindisi – Vlorë, bashkëshorti im ka marrë në përdorim nga shtetasi A. H. automjetin përkatës, gjithashtu ka marrë dhe automjetin me targa {***}, që është në pronësi të nënës së tij H. L., në mënyrë që të siguronte transportin tonë. Me shtetasin A. H., bashkëshorti ka pasur dhe ka marrëdhënie pune. Udhëtimet me këtë shtetas kanë qenë të shpeshta për shkak të ndjekjes së procesit gjyqësor në Itali të vëllezërve të shtetasit A. H., si dhe të kontakteve/komunikimeve që ka pasur me përfaqësuesit ligjorë të tyre jashtë shtetit. Bashkëshorti i ka përfaqësuar/përfaqëson edhe në proceset gjyqësore, që janë duke u zhvilluar ndaj tyre në Tiranë dhe Vlorë [...]. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka depozituar në Komision kopje të prokurave të përfaqësimit të anëtarëve të familjes H. nga ana e bashkëshortit të saj, si dhe të e-mail-eve të avokatëve italianë me bashkëshortin e saj.*

➤ *Lidhur me të dhënat e rezultuara gjatë hetimit administrativ në lidhje me shtetasit E. Xh. dhe E. Xh.:*

96. Trupi gjykues vëren se, referuar ankimit të Komisionerit Publik, bazuar mbi gjetjet e hetimit të kryer nga Komisioni, verifikuar edhe nga trupi gjykues pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të çështjes, ka rezultuar se:

(i) referuar të dhënave nga sistemi TIMS, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar në disa raste gjatë viteve 2019-2020, me shtetasin E. Xh., vëllai i shtetasit E. Xh.. Ky i fundit ka rezultuar gjithashtu gjatë hetimit në Komision, se ka depozituar 500 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë ABI Bank, më datë 31.01.2019, transaksion të cilin subjekti e ka shpjeguar si pagesë të këstit të kredisë për llogari të bashkëshortit të saj;

(ii) referuar burimeve të hapura, Komisioni ka konstatuar se shtetasi E. Xh. është hetuar për vepra penale të lidhura me trafikimin ndërkombëtar të narkotikëve⁴⁰, sipas të cilave rezultoi të jetë arrestuar në shtetin italian;

(iii) në kuadër të hetimeve të kryera nga Komisioni, nga informacioni i administruar prej këtij të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 19.09.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së

³⁸ Referuar informacionit të përcjellë me anë të shkresës nr. {***}, datë 27.6.2024.

³⁹ Shih faqen nr. 35 të rezultateve të hetimit: <https://www.balkanweb.com/sekuestrohet-karburanti-prone-e-familjes-h/#gsc.tab=0>.

⁴⁰ Shih faqen 36 të rezultateve të hetimit: [Un lungo appostamento, poi il blitz nella villetta: finanziere scovano 5 chili di eroina](#).

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, rezultoi se, për shtetasin E. Xh., është regjistruar procedimi penal me nr. {***}/2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal⁴¹, dhe në regjistrin e njoftimeve të veprave penale nuk ka të regjistruar emër personi nën hetim. Ky procedim penal, referuar kësaj shkrese, rezultonte në atë periudhë në proces hetimi.

97. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, kur është pyetur lidhur me konstatimet e mësipërme, është shprehur: *[...] Bashkëshorti im E. L. dhe shtetasi E. Xh. janë shokë, janë njohur në adoleshencë kur kanë qenë të angazhuar në të njëjtin klub sportiv dhe marrëdhëniet shoqërore ndërmjet tyre vijojnë edhe sot. Shtetasi E. Xh. është vëllai i shtetasit E. Xh. dhe bashkëshorti im ka/ka pasur dhe me të raport shoqëror. Në lidhje me konstatimin tuaj se unë kam udhëtuar disa herë me shtetasin E. Xh., sqaroj se unë kam udhëtuar vetëm një herë dhe në këtë udhëtim kam qenë bashkë me bashkëshortin tim dhe shtetasi E. ka qenë me bashkëshorten e tij, shtetasen D. Xh.. Ky udhëtim i referohet periudhës 23.5.2019 – 27.5.2019 [...].*

➤ *Lidhur me shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit të mbuluara nga klientët e bashkëshortit të subjektit:*

98. Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, është konstatuar nga përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, në pyetësorin standard, se ajo ka udhëtuar jashtë vendit me shpenzime të mbuluara në disa raste nga klientët e bashkëshortit. Konkretisht, është shprehur: *[...] Unë personalisht nuk kam marrë ndonjë dhuratë me vlerë më të lartë se 500 euro, ndërsa në lidhje me financimin e shpenzimeve për udhëtimet jashtë shtetit, më duhet të sqaroj se bashkëshorti im ushtron profesionin e avokatit dhe, në disa nga udhëtimet për shkak të punës të kryera prej tij dhe të mbuluara nga klientë të tij, kam qenë dhe unë bashkë me fëmijët e mi. Udhëtimet e punës të kryera në Itali nga bashkëshorti, janë “shfrytëzuar” në funksion të takimit të familjarëve të bashkëshortit tim, familjarët e tij, dy prindërit, motra e tij dhe vëllai i tij janë rezidentë në këtë shtet [...]. Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të datës 07.05.2024, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Lidhur me shpjegimet e dhëna në pyetësorin e parë se për disa udhëtime të caktuara, shpenzimet e udhëtimit detar janë mbuluar nga agjenci detare, në funksion të vërtetimit të këtij fakti po ju vë në dispozicion dokumentin “Deklaratë” e hartuar nga Agjencia Detare “{***}” ShPK dhe “Deklaratë” e hartuar nga Agjencia Detare “{***}” ShPK. Referuar këtyre deklaratave (shkresa të thjeshta), shoqëritë e sipërcituara, nëpërmjet nënshkruesve në cilësinë e përfaqësuesve të tyre, janë shprehur se avokati E. L. ka përfituar udhëtimet Vlorë – Brindisi – Vlorë, falas, gjatë periudhës së udhëtimeve me tragetin e shoqërive përkatëse. Sipas tyre: *Shërbim i ofruar ky për avokatin E. L., si mirënjohje për disponueshmërinë dhe shërbimet që ka bërë përkundrejt kompanisë sonë.***

99. Lidhur me çështjet e mësipërme objekt shqyrtimi mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik, në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

⁴¹ Neni 287 i Kodit Penal, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

99.1. Mbi gjetjet e rezultuara për shtetasit A. H., E. dhe E. Xh., për të cilat Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me (i) përdorimin e automjetit të personit të proceduar penalisht; dhe (ii) shoqërimin me persona me precedentë penalë, kjo e fundit ka mbajtur qëndrimin se: *Në lidhje me shtetasit A. H. dhe E. Xh. për të cilët keni referuar se nga burimet e hapura, në media, është konstatuar se shtetasi A. H. është akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, ndërsa shtetasi E. Xh. është hetuar për trafik të lëndëve narkotike nga shteti italian, nëse çdo informacion i marrë në media online, do të vlerësohej apriori si i vërtetë, eventualisht që cilido prej nesh mund të cenohej. [...] Sa i përket faktit të regjistrimit të një procedimi penal në vitin 2021, ju e keni konstatuar qartësisht se ky procedim penal është regjistruar dy vite më vonë nga koha kur unë dhe bashkëshorti im kemi udhëtuar me shtetasin E. Xh., viti 2019. E ritheksoj, sikundër kam sqaruar edhe më parë në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, se udhëtimi në vitin 2019 ka qenë udhëtimi im i vetëm në shoqërinë e personit në fjalë. Është shpjeguar qartësisht në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, se unë nuk kam pasur dhe nuk kam asnjë lloj njohje/kontakti me shtetasin A. H., një person ky që, nga verifikimet e kryera, rezulton i padënuar brenda dhe jashtë vendit. Për shtetasin E. Xh., di që është vëllai i shtetasit E. Xh., por nuk kam pasur dhe nuk kam asnjë lloj komunikimi apo lidhje me të. Shtetasit A. H., E. Xh. dhe E. Xh. rezultojnë me gjendje gjyqësore të padënuar më parë dhe dyshimi që është ngritur ndaj tyre si persona me precedentë penalë, në kuptim të ligjit penal, nuk qëndron.*

Të njëjtin qëndrim subjekti i rivlerësimit mbajti edhe në parashtrimet e saj para trupit gjykues në Kolegj.

99.2. Ndërsa, sa u takon udhëtimeve të punës së bashkëshortit të mbuluara nga klientët e tij, ku në disa raste ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit me fëmijët, Komisioni nuk duket t'i ketë kaluar kësaj të fundit barrë prove, por, në kuadër të barrës së provës lidhur me rezultatin e analizës financiare për periudhën e rivlerësimit, subjekti në shpjegimet e saj rezultoi të jetë përgjigjur: *Shpenzimet e udhëtimit, bazuar në të gjitha deklaratimet e mia, paraqitjen e deklaratave noteriale, si dhe natyrës së aktivitetit të ushtruar nga bashkëshorti, duhet të korrigjohen dhe mos të përlllogariten si kosto e përballuar nga familja ime. [...] Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, kam dorëzuar dokumentin “Deklaratë” e hartuar nga Agjencia Detare “{***}” ShPK dhe “Deklaratë” e hartuar nga Agjencia Detare “{***}” ShPK. Gjithsesi, në funksion të fuqisë së plotë provuese të dokumentacionit të depozituar, po ju vë në dispozicion edhe disa bileta udhëtimi që janë ruajtur në vitet e mëvonshme dhe që njëkohësisht vërtetojnë se përfaqësuesit e dy agjencive detare nuk kanë pasur arsye të “gënjejnë” dhe që konfirmojnë faktin se shpenzimet për udhëtimin detar kanë qenë falas.*

100. Në parashtrimet e saj në Kolegj lidhur me këtë çështje, subjekti ka prapësuar si tërësisht alogjik pretendimin e ankuesit se, duke pranuar të udhëtojë me bashkëshortin dhe fëmijët në disa udhëtime pune të tij, falas për shkak se agjencia detare që zotëron tragetin ia ka mundësuar këtë përfitim bashkëshortit të saj, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka pretenduar se shtetasit F. G. dhe A. B., që kanë dhënë edhe deklaratat

noteriale të sipërcituara, nuk kanë asnjë lidhje me të, as si prokurore, as si person. Gjithashtu, fakti që subjekti nuk ndodhet në konflikt interesi me këta persona vërtetohet edhe nga vërtetimi i zyrës së regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas të cilit evidentohet se për periudhën kohore tetor 2004 – tetor 2023, periudha e ushtrimit të detyrës pranë kësaj prokurorie, këta shtetas nuk kanë qenë subjekt procedimi penal në cilësinë e viktimës, personit të pandehur apo personit nën hetim, në çështjet penale që janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Për këtë qëllim, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në cilësinë e provës së re në proces edhe vërtetimin përkatës⁴².

101. Në analizë të sa më sipër lidhur me këtë shkak ankimi, nga shqyrtimi i legjislacionit në fuqi lidhur me përcaktimin e vlerave themelore të magjistratit⁴³ dhe standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes⁴⁴ që ata duhet të kenë gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij, në konsideratë edhe të akteve ndërkombëtare lidhur me trajtimin e këtyre çështjeve⁴⁵, të cilat vlerësohen si thelbësore në garantimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, duhet të kishte marrë masa të arsyeshme që sjellja e saj jashtë ushtrimit të detyrës, në përfitimet e trajtimeve preferenciale⁴⁶ për shkak të profesionit të bashkëshortit, apo vendosjes së kontakteve me klientë të tij, pavarësisht nëse nuk çmohen se përbëjnë shkelje në drejtim të konstatimit të një situatë konflikti interesi apo kontakti të

⁴² Shih shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nr. {***} prot. (P.H), datë 08.07.2025.

⁴³ Në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016 “Vlerat themelore” përcaktohet shprehimisht:

“1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. 2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye. 3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij. 4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij, garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi”.

⁴⁴ Shih nenin 4 të ligjit nr. 96/2016 “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes”, në të cilin përcaktohet:

“1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit. 3. Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. 4. Secili Këshill emëron magjistratin si këshilltarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

⁴⁵ Përveç sa referuar nga Komisioneri Publik në ankimin e tij, bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së, shih edhe Udhëzuesin Evropian mbi Etikën dhe sjelljen e Prokurorëve Publikë, të miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të vendeve të Këshillit të Evropës “The Budapest Guidelines”: <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>.

⁴⁶ Të cilat, përveç të tjerave, janë dhe objekt deklarimi periodik vjetor para ILDKPKI-së, referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.

papërshtatshëm⁴⁷, të udhëhiqej nga një standard i lartë kujdesi, në nevojën për të vendosur një ekuilibër të drejtë mes jetës profesionale dhe asaj private (si bashkëshorte e një avokati në fushën e së drejtës penale). Në referim të sa më sipër, sjellja e subjektit të rivlerësimit nuk duhet vetëm të jetë korrekte dhe e kujdesshme, por njëkohësisht edhe të duket e tillë, element ky i cili lidhet me perceptimin e një vëzhguesi të arsyeshëm⁴⁸.

102. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerësoi se problematikat e ngritura në ankim dhe të marra në shqyrtim si më sipër, në drejtim të vlerësimit të etikës së magjistratit, për disa udhëtime dhe kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona të dyshuar si të përfshirë në aktivitete kriminale, si dhe mbi pranimin e mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit nga klientët e bashkëshortit të saj, tregojnë për mungesë kujdesi nga ana e subjektit të rivlerësimit për ruajtjen të pacenuar të figurës së magjistratit jashtë ushtrimit të detyrës. Pavarësisht sa më sipër, këto problematika u vlerësuan se nuk ishin të mjaftueshme për t'u konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në atë nivel që të mund të justifikohet dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

103. Në përfundim të gjykimit, në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të këtij kriteri në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, çmohet se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, nuk është i bazuar në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁴⁷ Në kuptim të legjislacionit të zbatueshëm në kuadër të kontrollit të figurës së subjekteve të rivlerësimit.

⁴⁸ Rëndësia e standardeve të komunitetit (UNODC, Komentari mbi Parimet e Bangaloreve të Sjelljes Gjyqësore, 2007), paragrafi 102: “Ndërsa parimi i integritetit është i lehtë për t'u deklaruar në terma të përgjithshëm, është shumë më e vështirë dhe ndoshta edhe e pamundur ndonjëherë ta vësh në zbatim në terma më specifikë. Efekti i sjelljes në perceptimin e komunitetit varet në mënyrë të konsiderueshme nga standardet e komunitetit që mund të ndryshojnë sipas vendit dhe kohës. Kjo duhet mbajtur parasysh në shqyrtimin se si një sjellje e caktuar mund të perceptohet nga anëtarët e arsyeshëm, me mendje të drejtë (logjike) dhe të informuar të atij komuniteti përkatës, dhe nëse një perceptim i tillë ka të ngjarë të zvogëlojë respektin e komunitetit për gjyqtarin ose gjyqësorin në tërësi, çdo sjellje që ka të ngjarë të ulë respektin në mendjet e këtyre personave, duhet të shmanget.

Gjyqtari duhet të sigurohet që nga këndvështrimi e një vëzhguesi të arsyeshëm, sjellja e tij ose e saj të jetë korrekte dhe e paqortueshme”.

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 811, datë 08.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.07.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

Nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi